



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:094963
Datë: 27.03.2025
Numri i dokumentit: 07051283

APS.nr.20/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti Special, në Kolegjin Penal të përbërë nga gjyqtarët, Vaton Durguti kryetar, Burim Ademi dhe Afërdita Bytyçi anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Gazmend Ramadani, në çështjen penale ndaj të akuzuarve Gani Bajraktari, Faik Shatri, Hamza Selmani, Banush Gashi, Fisnik Hima, Kelmend Pallaska, Hajdin Qitaku, Agim Krasniqi, Ejup Pllana, Edmond Haliti, Afrim Poniku, Nebih Musliu, Dardan Koqinaj, Arlind Batalli, Xhevdet Krasniqi, Lazër Prekpalaj, Rexhep Manaj për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 422 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.3 lidhur më nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK-së), të akuzuarve Gani Bajraktari, Nehat Rexhepi, Agim Krasniqi, Sami Gjoka, Florim Sadiku, Lulzim Kamberi, Hamza Selmani, Bedri Zaiti, Reshat Emra, Halim Halili, Banush Gashi, Ferid Susuri, Agron Leka, Agron Besimi, Hajdin Qitaku, Galina Berisha, Bajram Mziu, Driton Miftari, Besnik Koliqi, Ferihane Sefa, Masar Gashi, Mirdi Strana, Shemsedin Shabollari, Fisnik Hima, Kelmend Pallaska, Besim Guda, Bajram Preteni, Faik Shatri, Murat Abazi, Ismail Avdimetaj, Petrit Ademaj, Afërdita Selmanaj, Sali Shala dhe Luan Pazhari për shkak të veprave penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar secili veç e veç nga neni 422 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.2 dhe 2.4 të KPRK-së dhe veprës penale Marrje e ryshfetit secili veç e veç nga neni 428 paragrafi 2 dhe 3 të KPRK-ës, duke vendosur lidhur me ankesën e ushtruar nga Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti Special, PKR.nr.40/2018 të datës 20.09.2023, në seancën e kolegjit me datë 08.07.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, PKR.nr.40/2018 të datës 20.09.2023, **VËRTETOHET**

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti Special, ka marrë aktgjykimin PKR.nr.40/2018 të datës 20.09.2023 me të cilin të Gani Bajraktari, Faik Shatri, Hamza Selmani, Banush Gashi, Fisnik Hima, Kelmend Pallaska, Hajdin Qitaku, Agim Krasniqi, Ejup Pllana, Edmond Haliti, Afrim Poniku, Nebih Musliu, Dardan Koqinaj, Arlind Batalli, Xhevdet Krasniqi, Lazër Prekpalaj, Rexhep Manaj për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 422 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.3 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK-së), të akuzuarve Gani Bajraktari, Nehat Rexhepi, Agim Krasniqi, Sami Gjoka, Florim Sadiku, Lulzim Kamberi, Hamza Selmani, Bedri Zaiti, Reshat Emra, Halim Halili, Banush Gashi, Ferid Susuri, Agron Leka, Agron Besimi, Hajdin Qitaku, Galina Berisha, Bajram Mziu, Driton Miftari, Besnik Koliqi, Ferihane Sefa, Masar Gashi, Mirdi Strana, Shemsedin Shabollari, Fisnik Hima, Kelmend Pallaska, Besim Guda, Bajram Preteni, Faik Shatri, Murat Abazi, Ismail Avdimetaj, Petrit Ademaj, Aferdita Selmanaj, Sali Shala dhe Luan Pazhari për shkak të veprave penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar secili veç e veç nga neni 422 paragrafi 1 dhe 2 nënparagrafi 2.2 dhe 2.4 të KPRK-së dhe veprës penale Marrje e ryshfetit secili veç e veç nga neni 428 paragrafi 2 dhe 3 të KPRK-ës, pasi që nuk është provuar se të pandehuri të ketë kryer veprat penale me të cilat akuzohet. Shpenzimet e procedurës janë ra në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës, kurse të dëmtuarit: Sh.A, I.S, A.B, N.H, B.A, A.N, H.K, Sh.H, L.E, Sh.B, T.G, Z.B, L.B, A.D, B.R, U.K, L.Rr, për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

Kundër këtij aktgjykimi ka parashtruar ankesë Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, dhe shkeljes se ligjit penal, me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe të prish aktgjykimin e ankimuar dhe të pandehurin ta shpall fajtor ose të anuloj aktgjykimin e ankimuar dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës kanë parashtruar:

Mbrojtësi i të akuzuarit Gani Bajraktari av.Reshat Millaku me propozim që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Mbrojtësja e të akuzuarit Faik Shatri av.Flutra Hoxha me propozim që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit Banush Gashi av.Naser Gashi me propozim që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit Kelmend Pallaska av.Ramë Dreshaj me propozim që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet në rapoer me të akuzuarin.

Mbrojtësi i të akuzuarit Agim Krasniqi av.Sahit Bibaj me propozim që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit Afrim Potoku av.Zijadin Spahiu me propozim që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit Nebih Musliu av.Rahman Kastrati me propozim që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit Lazer Prekpalaj av.Ndue Thaçi me propozim që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Mbrojtësit e të akuzuarit Nehat Rexhepaj avokatët Selami Rexhepi dhe Shemsedin Piraj me propozim që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Mbrojtësja e të akuzuarit Florim Sadiku av.Diellza Kuliqi me propozim që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit Lulzim Kamberi av.Blerim Xharravina me propozim që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit Agron Besimi av.Shqipron Zymeri me propozim që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit Driton Miftari av.Vehbi Beqiri me propozim që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Mbrojtësja e të akuzuarit ShemsedinShabollari av.Myrvete Çollaku me propozim që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Mbrojtësja e të akuzuarit Besim Gruda av. Bedrie Rexhepi me propozim që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit Petrit Ademaj av. Dukagjin Kërveshi me propozim që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Mbrojtësi i të akuzuarës Afërdita Selmaja av.Kadri Mjekiqi me propozim që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit Luan Pazhari av. Ilir Rashitime propozim që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit, ka paraqitur parashtresën me shkrim PPA/I.nr.285/2024 të datës 27.05.2024, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Speciale të Kosovës, kurse aktgjykimi i ankimuar të priset dhe te akuzuarit të shpallen fajtor, ose i njëjti të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje, kurse përgjigjigjet në ankesën e Prokurorisë Speciale të Kosovës të parashtruar nga mbrojtësit e të akuzuarve të refuzohen si e të pabazuar.

Gjykata e Apelit fillimisht ka vlerësuar ankesën nëse është e lejueshme dhe e afatëshme. kolegji ka gjetur se ankesa është e lejueshme, duke qenë se është parashtruar nga ana e Prokurorisë speciale të Kosovës. Po ashtu ankesa rezulton se është e afatëshme, pasi që nga shkresat e lëndës

rezulton se aktgjykimi i ankimuar është pranuar nga prokuroria me datë 14.03.2024, ndërsa ankesa është parashtruar me datë 12.04.2024. Nga këto rrethana rezulton se ankesa është brenda afatit që parasheh neni 380 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata ka caktuar seancën e kolegjit në të cilën ka njoftuar palët për vendin, dhe orën e mbajtjes së seancës. Në këtë seancë nuk ka prezantuar Prokurori i Prokurorisë së Apelit, i akuzuari Faik Shatri, dhe mbrojtësi i tij Hamza Selmani, i akuzuari Banush Gashi, i akuzuari Fisnik Hima, i akuzuari Hajdin Qitaku dhe mbrojtësi i tij Dafina Osmani, i akuzuari Agim Krasniqi, i akuzuari Ejup Pllana, dhe mbrojtësi i tij av. Visar Haxhibeqiri, i akuzuari Edmond Halili, i akuzuari Afrim Pniku, i akuzuari Nebih Musliu, i akuzuari Dardan Koqinaj, i akuzuari Xhevdet Krasniqi, i akuzuari Lazër Prekpalaj dhe mbrojtësi i tij av. Ndue Thaçi, i akuzuari Rexhep Manaj, dhe mbrojtësi i tij av. Armend Krasniqi, i akuzuari Nehat Rexhepaj, mbrojtësi i tij Shemsedin Piraj, i akuzuari Florim Sadiku, i akuzuari Lulzim Kamberi, avokati Ruzhdi Berisha, i akuzuari Agron Leka, e akuzuara Galina Berisha, av. Prenk Pepaj, i akuzuari Bajram Mziu, av. Jeton Osmani, i akuzuari Driton Miftari av. Vehbi Beqiri, i akuzuari Besnik Koliqi, av. Armand Shkoza, i akuzuari Mirdu Strana, av. Mahmut Halili, i akuzuari Shemsedin Shabollari, i akuzuari Besim Gruda, i akuzuari Bajram Preteni, av. Doruntina Preteni, i akuzuari Ismajl Avdimetaj, i akuzuari Petrit Ademaj, e akuzuara Afërdita Selmanaj, i akuzuari Salih Shala, i akuzuari Luan Pazhari, av. Ilir Rashiti, i dëmtuari Sh.A, i dëmtuari N.H, i dëmtuari B.A, i dëmtuari A. N, i dëmtuari Sh.H, i dëmtuari T.G, e dëmtuara Z. B, i dëmtuari A.D, e dëmtuara B.R, i dëmtuari U.K, i dëmtuari L.Rr, edhe pse ftesa janë dërguar në mënyrë të rregullt.

Ndërsa, janë të pranishëm: I akuzuari Gani Bajraktari, mbrojtësi i tij, av. Reshat Millaku, av. Flutra Hoxha; av. Naser Gashi; av. Driton Muharremi; i akuzuari Kelmend Pallaska, av. Ramë Dreshaj, av. Sahit Bibaj; av. Gent Spahija; av. Zijadin Spahiu; av. Rrahman Kastrati, av. me autorizim zëvendësues Mevlyde Qerimi, i akuzuari Arlind Batalli, av. Kadri Begolli, av. me autorizim zëvendësues Rrahim Ajeti, av. Selami Rexhepi, av. Diellza Kuliqi, av. Blerim Xharravina, i akuzuari Halim Halili, i akuzuari Agron Besimi, av. Shqipron Zymberi, av. Myrvete Çollaku, av. Dren Salihu, av. me autorizim zëvendësues Etnik Maloku, av. Kadri Mjekiqi, av. Driton Musliu, i dëmtuari I.S, i dëmtuari A.B, i dëmtuari H.K, i dëmtuari L.E, pala e dëmtuar (për të ndjeri Sh.B) K. B, i dëmtuari U.K

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, propozimin e Prokurorisë së Apelit, dhe duke analizuar shkresat e lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore.

Në ankesë Prokuroria Speciale e Kosovës konsideron se mbi bazën e të gjitha provave të prezantuara është vërtetuar se Spitali privat EDA ka qenë i licencuar nga MSH me datë 03.06.2009 me numër të licencës 05/14 dhe licenca ishte vërtetuar gjerë datë 02.06.2012. Gjithashtu është konstatuar se datë 02.06.2009 deri më datë 06.02.2014 ka munguar Vula e vërtetimit të licencës nga data 03.06.2010 gjerë më datë 02.06.2012, se ky spital nuk ka pasur licence e cila i ka përfunduar datë ku themeluesi i këtij institucioni ka aplikuar në MSH për licencë Pune të re me datë 16.05.2014 dhe është licencuar me datë 22.08.2014 me numër të licencës 05/2014. Ndërsa në periudhën kohore 03.06.2014 gjerë 22.08.2014 Spitali Special për sëmundje kardiovaskular e nuk kishte licencë Pune si institucion privat shëndetësor por i njëjti kishte vazhduar me ofrimin e shërbimeve shëndetësore ku 136 pacientë i janë nënshtruar intervenimit nga kardiologjia invazive, vendosja e stendave, e është vërtetuar sipas librit të protokollit të pacientëve që i janë nënshtruar intervenimeve, me numër serik 0086 ndërsa 23 pacientë i janë nënshtruar ekzaminimit koronografik. Tutje pretendon se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika l. 12, ngase aktgjykimi i atakuar nuk është përpiluar në pajtim më neni 370 par. 7 të KPPK, meqë gjykata nuk ka vlerësuar saktësinë e provave kundërtënëse, në atë mënyrë që edhe pse i ka administruar si prova nuk ua ka fale besimin provave materiale të siguruar me urdhër të Gjykatës, me aplikimin e masave të fshehta të vëzhgimit e të hetimit-përgjim i telekomunikimeve të cilat dëshmojnë se mjeket që punonin në Institucione publike kishin marrë ryshfet nga të pandehurit të cilët edhe pse kishin një gjykim për periudhën 2009 - 30.09.2012 të njëjtit kanë vazhduar edhe pas kësaj date të referonin/dërgonin pacientë në spitalin IMI, andaj të gjithë të pandehurit që morën ryshfet vazhduan të dërgonin pacientë në spitalin IMH dhe në veprimet e tyre i shkaktonin dëm financiar pacientit nga 700.000 deri në 13,000.00 Euro. Gjithashtu pretendon se në bazë të raportit të auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin e përfunduar më 31.12.2013 rezulton se në spitalet private IMII dhe EDA trajtimi i pacientëve është dashur të bëhet pas konfirmimit nuk ka kushte për trajtim të sëmundjes në

institucionet publike shëndetësore, Megjithatë rastet e testuar është gjetur se pacientët janë trajtuar pa një udhëzim të tillë. Gjithashtu sipas këtij raporti pas barazimeve financiare ka rezultuar se vetëm në dy këto institucione shëndetësore private kishte një shumë prej 125.582 Euro të paguara të cilat këto institucione nuk kishin ofruar shërbime dhe se mungesa e raportimeve për kostot e trajtimit të pacientëve ka rritur dyshimin dhe mundësinë e keqpërdorimit të këtyre mjeteve. Sa i përket vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike konsideron se gjykata e shkallës së parë gabimisht i ka vërtetuar faktet dhe si rezultat ka nxjerr përfundime të gabuara sa i përket ekzistimit apo mos ekzistimit të fakteve që vërtetojnë gjendjen faktike dhe veprën penale Marrja e ryshfetit, ngase përgjimet, raporti dhe fletorët dëshmojnë se mjekët që punonin në Institucionet Publike Shëndetësore, duke përfshirë këtu edhe të pandehurin Murat Abazi që punonte si zyrtar - infermier në zyrën për trajtim mjekësor Jashtë QKUK-së, kishin marr ryshfet nga të pandehurit: Ali Hocaoglu, Astrit Bakiqi, Abdullah Tuna, Driton Sylejmani dhe Arton Beqiri që punonin në spitalin privat Internacional Medicine Hospital. Sa i përket shkeljes së ligjit penal konsideron faktin se edhe pse janë administruar prova të mjaftueshme materiale në bazë të të cilave gjykata do të mund të shpallë fajtor dhe do të dënonte pandehurit, për shkak të vlerësimit të gabuar të provave dhe faljes besimit mbrojtjes së të pandehurve, nxjerr përfundime të gabuara lidhur me ekzistimin e fakteve që e vërtetojnë gjendjen faktike duke i liruar të pandehurit. Andaj propozon që ankesa e Prokurorisë Speciale të Kosovës të refuzohet si e pabazuar dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit ka parasysh se prokuroria ka parashtruar ankese për sa i përket shkeljeve esenciale ete dispozitave të procedurës penale, që pretendohet se aktgjykimi është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par 2 nën paragrafi 2.7 e lidhur me nenin 370 të kodit të procedurës penale të Kosovës, sipas se cilës baze prokuroria pretendon se aktgjykimi nuk është përpiluar në përputhje me dispozitat ligjore dhe se nuk janë vlerësuar provat kundërtënëse.

Gjykata duke vlerësuar aktgjykimin e ankimuar duke shqyrtuar pretendimet ankimore të prokurorisë sipas pretendimeve që ngritën nga prokuroria kjo gjykate ka vlerësuar aktgjykimin edhe bazuar në nenin 394 paragrafi 1, e cila dispozite ka përcaktuar se Gjykata e Apelit me rastin e shqyrtimit të ankesës gjithnjë shqyrton sipas detyrës zyrtare nëse aktgjykimi është i përfshirë me shkelje esenciale nga neni 384 paragrafi 1 shkelje këto që janë të karakterit absolut, andaj

kolegji gjen se aktgjykimi i gjykatës themelore nuk është i përfshirë me shkelje nga neni 384 paragrafi 1 dhe as me shkelje nga neni 384 paragrafi 2 nën paragrafi 2.7 që i pretendon prokuroria ne ankese e te cilat do te kushtëzonin anulimin e aktgjykimit.

Kolegji gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është përpiluar ne përputhje me kërkesat ligjore nga neni 369, ku rrjedhe se aktgjykimi në pjesën e dispozitivit të tij është i qartë pasi që përshinë gjendjen faktike të pretenduar në aktakuzë gjë që rezulton se në rrethanat faktike janë përshkruara si koha vendi dhe mënyra që pretendohej se janë kryer veprat penale që iu ngarkohej te pandehurve Gani Bajraktari, Faik Shatri, Hamza Selmani, Banush Gashi, Fisnik Hima, Kelmend Pallaska, Hajdin Qitaku, Agim Krasniqi, Ejup Pllana, Edmond Haliti, Afrim Poniku, Nebih Musliu, Dardan Koqinaj, Arlind Batalli, Xhevdet Krasniqi, Lazër Prekpalaj, Rexhep Manaj për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 422 par.1 dhe 2 nën paragrafi. 2.1 dhe 2.3 lidhur më nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK-së), si dhe ne piken II te dispozitivit qe iu ngarkohej të akuzuarve Gani Bajraktari, Nehat Rexhepi, Agim Krasniqi, Florim Sadiku, Lulzim Kamberi, Hamza Selmani, Halim Halili, Banush Gashi, Agron Leka, Agron Besimi, Hajdin Qitaku, Galina Berisha, Bajram Mziu, Driton Miftari, Besnik Koliqi, Mirdi Strana, Shemsedin Shabollari, Fisnik Hima, Kelmend Pallaska, Besim Guda, Bajram Preteni, Faik Shatri, Murat Abazi, Ismail Avdimetaj, Petrit Ademaj, Aferdita Selmanaj, Sali Shala dhe Luan Pazhari për shkak të veprave penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar secili veç e veç nga neni 422 par.1 dhe 2 nënparagrafi 2.2 dhe 2.4 të KPRK-së dhe veprës penale Marrje e ryshfetit secili veç e veç nga neni 428 paragrafi 2 dhe 3 të KPRK-ës. Në pjesën e përshkrimit faktik dispozitivi nuk rezulton që të këtë kundërthënie me veten apo me arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë.

Kolegji i gjykatës së Apelit poashtu vëren se aktgjykimi në pjesën e arsyetimit i referohet provave që janë administruara në shqyrtimin gjyqësor në raport me faktet që kanë qenë objekt i akuzës që ngarkoheshin te pandehurit, gjë që nga arsyetimi rezulton se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye në raport me të gjitha provat që janë administruara duke arsyetuar konkretisht se cilave prova ua ka falur besimin dhe cilave nuk ua ka falur besimin ne raport me faktet e çështjes penale.

Nga aktgjykimi i ankimuar rezulton se gjykata e shkallës së parë kur ka vlerësuar provat që janë administruara në shqyrtimin gjyqësor, ka dhënë arsye si për sa i përket të provuarit të gjendje faktike ashtu edhe kundërthënieve që ekzistojnë në provat që janë administruar duke arsyetuar

se perse ka ardhur në konkludimin që ka konstatuar se nuk është provuar se te pandehurit kanë kryer veprat penale që u ngarkoheshin sipas akuzës, arsye këto që edhe gjykata e apelit i vlerëson si të drejta dhe qojnë në konkludimin që ka nxjerr gjykata e shkallës së parë se nuk është provuar se te pandehurit kanë kryer veprat penale.

Kolegji ka parasysh se prokuroria në ankesë lidhur me bazën ankimore për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, thekson se gjykata ka bërë shkelje esenciale nga neni 384 lidhur me nenin 369 paragrafi 7 i Kodit të procedurës penale duke theksuar se gjykata e shkallës së parë nuk ua ka falur besimin provave që i ka administruar e që janë siguruar përmes urdhrave gjyqësor.

Kolegji ka parasysh se, dispozita nga neni 369 paragrafi 7 ka përcaktuar se, “Gjykata paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara. Gjykata gjithashtu, në mënyrë të veçantë vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse, arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve, si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës së tij”.

Në dritën e kësaj dispozite që përcakton detyrimet e gjykatës për të dhënë arsye lidhur me provat dhe mospërputhjet e provave nga ana e gjykatës, e duke pasur për bazë se nga aktgjykimi i arsyetimit të ankimit rrjedhë se Gjykata ka dhënë arsye në raport me të gjithë dëshmitarët e dëgjuar në shqyrtimin gjyqësorë si dhe në raport me të gjitha provat material rrjedhë se gjykata ka përmbushur detyrimet nga neni 369 paragrafi 7 i Kodit të procedurës penale.

Kolegji nuk e gjen të bazuar pretendimin e prokurorisë së gjykata e shkallës së parë nuk i ka falur besimin provave që janë administruar në shqyrtim gjyqësorë përkundër se janë siguruar përmes urdhërësive të gjykatës. Për kolegjin e gjykatës se Apelit edhe në rastet kur një prove kërkon që sipas kodit të procedurës penale duhet të sigurohet përmes urdhërësive të gjykatës, prova e tillë detyrimisht i nënshtrohet vlerësimit që gjykata duhet të ia bëjë sipas nenit 360 paragrafi 2 që duhet vlerësuar të gjitha provat një nga një dhe në lidhmërinë e tyre së bashku në raport me faktet që i ngarkohen në barrë të pandehurit për të ardhur në një përfundim të arsyeshëm nëse provohet se është kryer vepra penale.

Kolegji vlerëson se me rastin e vlerësimit të provave nga gjykata e shkallës së parë rezulton se gjykata ka zbatuar në përpikëri detyrimet e vlerësimit të provave nga neni 360 paragrafi 2, për çka ka dhënë arsye në raport me secilën provë që ka administruara si për sa i përket besueshmërisë lidhmërisë se provave me faktet e çështjes ashtu edhe mospërputhjes se provave që janë administruara qofte me provat apo me faktet e çështjes, rrjedhimisht nga kjo rezulton se aktgjykimi ka përmbushur vlerësimin e provave sipas kushteve ligjore, dhe se nuk ka asnjë rrethanë që e bënë të besueshme arsyen e prokurorisë se gjykata nuk ka vlerësuar provat, ndërsa vlerësimi sikurse janë arsyetuar në aktgjykimin e ankimuar rezulton se nga gjykata themelore nuk është bërë në mënyrë arbitrare i provave por është bërë në përputhje me nenin 360 paragrafi 2 të KPP-së.

Andaj për të gjitha këto arsye kolegji gjen se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale qofshin ato që kujdeset Gjykata e apelit sipas detyrës zyrtare apo sipas pretendimeve të ankesës së prokurorisë.

Lidhur me pretendimet ankimore të prokurorisë për sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, kolegji i gjykatës së apelit fillimisht ka parasysh se prokuroria në ankese, nuk ka specifikuar në mënyrë konkrete se cili fakt pretendohet se është vërtetuar në mënyrë të gabuar për tu konsideruar se gjendja faktike është vërtetuar gabimisht, apo se cili fakt nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë për tu konsideruar se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë. Prokuroria në ankese për sa i përket kësaj baze ligjore ka cituar provat që janë administruar në shqyrtim gjyqësor dhe pretendon se po të ishin vlerësuar drejta provat e cituara do të vërtetoheshin drejta gjendja faktike dhe poashtu do të nxirreshin përfundimet e drejta nga gjykata e shkallës së parë për çka edhe do të shpalleheshin fajtor të pandehurit.

Kolegji i gjykatës së Apelit duke i vlerësuar pretendimet e prokurorisë ka gjetur se nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe se të drejta e të ligjshme i konsideron përfundimet e nxjerra se nuk është provuar se të pandehurit kanë kryer veprat penale për të cilat ngarkoheshin.

Fillimisht Kolegji i Gjykatës së Apelit vëren se të pandehurit ngarkoheshin për dy vepra penale, dhe atë; Veprën penale të keqpërdorimit të detyrës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1 dhe 2 nënparagrafi 2.3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe për piken 2 të dispozitivit ngarkoheshin për veprën penale Keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar nga neni 422

paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2 nënparagrafi 2.4 e lidhur me veprën penale Marrje e rryshfetit nga neni 428 paragrafi 2 dhe 3 i KPRK-së.

Kolegji vëren se në pikën 1 të dispozitivit të pandehurit Gani Bajraktari, Faik Shatri, Hamza Selmani, Banush Gashi, Fisnik Hima, Kelmend Pallaska, Hajdin Qitaku, Agim Krasniqi, Ejup Pllana, Edmond Haliti, Afrim Poniku, Nebih Musliu, Dardan Koqinaj, Arlind Batalli, Xhevdet Krasniqi, Lazër Prekpalaj, Rexhep Manaj ngarkoheshin për Keqpërdorimin i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 422 par.1 dhe 2 nën paragrafi. 2.1 dhe 2.3 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, që në periudhën prej 01.01.2011 deri me 31.12.2015 si persona zyrtar në pozitën e tyre mjek në SHSKUK, ashtu që kanë tejkaluar kompetencat si anëtar të komisioneve konzoliare, kanë lëshuar letra referuese për trajtim jashtë institucioneve publike shëndetësore se pakur 233 letra referuese për personat edhe pse kishin marr trajtim mjekësor e në disa raste edhe pse pacientet kishin vdekur, ashtu që në kundërshtim me nenin 53 të ligjit për shëndetësinë ashtu që letrat referuese duhet të lëshonin pacienteve kur konstatojnë se në asnjërin nga tri nivelet e shërbimeve shëndetësore në sistemin publik shëndetësor nuk mund të ofrohej shërbimi i tillë shëndetësor dhe vetëm pastaj ti referonin pacientët për trajtim jashtë institucioneve shëndetësore publike e jo ti lëshonin letrat referuese pasi që pacientët kishin kryer të gjitha trajtimet jashtë institucioneve publike” .

Fillimisht kolegji rikujton se vepra penale nga nenin 422 e keqpërdorimit të detyrës apo autoritetit zyrtar ka parapare elementet konstitutive të veprës penale – “actus reus” që janë: a). Keqpërdorimi i detyrës zyrtare qoftë – duke tejkaluar kompetencat apo duke mos përmbushur detyrat zyrtare që nënkupton se forma e kryerjes se kësaj vepre penale përbëhet nga ndonjëra prej këtyre mënyrave, ekzistimi i qëllimit “means rea”, që ky qëllim duhet të ketë në vetvete, qëllimin e përfitimit qoftë për vete apo për personin tjetër, gjegjësisht që ky qëllim duhet të ekzistoj në vetvete për shkaktimin dëmit personit të tret.

Në rastin konkret prokuroria ngarkonte te akuzuarin se, veprën penale e ka kryer duke i tejkaluar kompetencat zyrtare dhe këtë pretendim e ndërlidhë me detyrën e te akuzuarit sipas ligjit për shëndetësinë në nenin 53 të ligjit nr., 04/L-125 i dekretuar me date, 13.12.2012.

Kolegji i Gjykatës së Apelit vëren se dispozita e ligjit për shëndetësinë në nenin 53 ka përcaktuar se: “ **Neni 53 Qasja** 1. Qasja, niveli i qasjes, dhe autorizimi i qasjes në SISHT përcaktohet nga Ministria, në pajtim me aktin nën-ligjor nga paragrafi 2., neni 49 i këtij ligji. 2. Institucionet shëndetësore, me qëllim të sigurimit të

vazhdimësisë së ofrimit të shërbimeve shëndetësore janë të obliguara që të sigurojnë qasje në të dhënat përkatëse elektronike ose kur ato nuk ekzistojnë, të njoftojnë me shkrim institucionin shëndetësor ku referohet shfrytëzuesi për diagnostikim, trajtim, ose rehabilitim të mëtutjeshëm”.

Kolegji vëren se kjo dispozite që prokuroria pretendon se të pandehurit kanë cenuar e rrjedhimisht kanë tejkualuar kompetencat e tyre, nuk rregullon kompetencën e një personi zyrtar – ne rastin konkret një Mjeku si i punësuar ne SHKUK, dispozita që prokuroria thekson rregullon çështjen e detyrimit institucional shëndetësor lidhur me Sistemin Informativ Shëndetësor, gjegjësisht kjo dispozite nuk ka të bëjë fare me kompetencat e mjekut për të dhënë apo mos dhënë letrën referuese për trajtimin shëndetësor që duhet të marr një pacient ne kuadër te institucioneve publike shëndetësore apo ne kuadër te institucioneve shëndetësore jo publike, për çka pacienteve ju takonte e drejta ne mbulimin e shpenzimeve kur ata merrnin shpenzimet e tilla shëndetësore jashtë institucioneve publike.

Pra kolegji në radhët të pare vëren se prokuroria ka dështuar që të vërtetoj se cilat kompetenca i kanë tejkualuar të pandehurit përderisa kanë dhënë letrat referuese për pacientët qe kishin nevojë për trajtim qoftë te diagnostikimit përmes koreografive apo ndërhyrjes përmes stentimit që u janë bërë pacienteve jashtë institucioneve publike.

Kolegji poashtu ka parasysh se prokuroria për sa i përket pikës I të dispozitivit e ngarkonte të pandehurit se duke lëshuar letrat referuese për se paku 233 pacient për trajtim jashtë institucioneve publike ne tersi nga te gjithë te akuzuarit ku spitalet private IMH dhe Eda, kanë pranuar shumen prej 4.555.553 euro, me çka i ka shkaktuar dem buxhetit te Kosovës ne shumen prej 11.430 euro.

Kolegji vëren se letra referuese qe lëshonte grupi i mjekeve konsoliar nuk ishte vendim për rimbursim te pacienteve, por ishin për konstatimin e nevojës se diagnostikimit apo ndërhyrjes ndaj pacienteve. Rrjedhimisht përmes letrave referuese nuk rezulton se krijohej pasoja e veprës penale gjegjësisht e dëmtimit te buxhetit, duke qenë se përmes letrës referuese që jepej për pacientët nuk rezulton se kishte disbursim te mjeteve monetare për rimbursimin e pacienteve pasi që kjo kompetencë i takonte tërësisht një institucioni tjetër që është Ministria e Shëndetësisë gjegjësisht Komisioni përkatës që kishte procedurën e shqyrtimit të kërkesave për rimbursim te pacientëve që trajtoheshin pranë spitaleve private, prandaj duke qenë se veprimet e të pandehurve edhe me rastin e lëshimit të letrave referuese nuk kanë krijuar pasojën rezulton se ndërmjet

veprimeve dhe pasojës mungon lidhja kauzale për veprën penale ne raport me atë çka prokuroria e ngarkonte të pandehurin.

Kolegji poashtu ka parasysh se prokuroria i referohet ligjit për shëndetësi që rezulton se në gazetën zyrtare ishte shpallur me nr. 13 me date 07.maj 2013, dhe ka hyrë në fuqi 15 dite pas shpalljes ne gazetën zyrtare, ndërsa për tejkallim te kompetencave prokuroria i ngarkonte të pandehurit për periudhën nga data 1 janar 2011 deri ne date 31 dhjetor 2015, gjë që rezulton se prokuroria ngarkonte të pandehurit se kishte keqpërdorur detyrën zyrtare duke tejkalluar kompetencat zyrtare, duke përfshirë edhe periudhën kohore kur nuk ishte në fuqi ligji për shëndetësinë nr.04/L-125 te cilit i referohet, andaj edhe për këto rrethana kolegji i Gjykatës se Apelit vëren se gjykata e shkalles se pare drejtë dhe ne mënyrë te plote ka vërtetuar gjendjen faktike pasi që nuk mund ti atribuohet si veprim në tejkallim të detyrave zyrtare një personi zyrtar përderisa rezulton se i referohet ligjit që nuk ka qenë në fuqi në tërë kohëzgjatjen e periudhës qe i ngarkohet vepra penale.

Prandaj se pretendimet e prokurorisë për vërtetim të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike janë te pabazuara, duke marr për baze arsyet e theksuara si me sipër e duke i pranuar arsyet e dhëna nga gjykata e shkalles se pare sipas te cilave arsye ka konkluduar se nuk është provuar se te pandehurit kanë kryer veprën penale, kolegji vlerëson se drejtë dhe në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike dhe se i drejtë dhe i ligjshëm është aktgjykimi me të cilin të pandehurit janë liruar nga akuza.

Duke vlerësuar pretendimet e prokurorisë për vërtetim jo të drejtë dhe të gabuar të gjendjes faktike për sa i përket pikës II të dispozitivit ku te pandehurit Gani Bajraktari, Nehat Rexhepi, Agim Krasniqi, Florim Sadiku, Lulzim Kamberi, Hamza Selmani, Halim Halili, Banush Gashi, Agron Leka, Agron Besimi, Hajdin Qitaku, Galina Berisha, Bajram Mziu, Driton Miftari, Besnik Koliqi, Mirdi Strana, Shemsedin Shabollari, Fisnik Hima, Kelmend Pallaska, Besim Guda, Bajram Preteni, Faik Shatri, Murat Abazi, Ismail Avdimetaj, Petrit Ademaj, Afërdita Selmanaj, Sali Shala dhe Luan Pazhari për shkak të veprave penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar secili veç e veç nga neni 422 par.1 dhe 2 nënparagrafi 2.2 dhe 2.4 të KPRK-së dhe veprës penale Marrje e ryshfetit secili veç e veç nga neni 428 paragrafi 2 dhe 3 të KPRK-ës, kolegji ka parasysh se prokuroria e ngarkonte për këto rrethana faktike, se: “ Te pandehurit nga data 01.01.2011 deri me date 31.12.2015 duke vepruar si persona zyrtar kanë keqpërdorur detyrën zyrtare në atë mënyrë që në bashkëpunim me të pandehurit Ali Hociogly, Astrit Bakiq, Driton

Sylejmani, Arton Beqiri dhe Avdullah Tuna në Spitalin Privat IMH, me Lulzim Brovinen dhe Borche Petrovskin në Spitalin Privat EDA, ishin marrë vesh që pacientët që kanë shkuar për kontroll në institucion publik shëndetësor ku kanë punuar këta të pandehur, në vend që t'i kryenin veprimet për të cilat kanë qenë te autorizuar t'i respektonin, mënyrën e referimit dhe pacientët t'i udhëzonin në Njësinë Invazive kompetente në Klinikën e Kardiologjisë në SHSKUK në Prishtinë, të njëjtit nuk kanë vepruar në këtë mënyrë por pacientet i kanë referuar në Spitalet Private IMH dhe EDA dhe për këto veprime merrnin rryshfet, ku për çdo pacient që dërgonin për vendosjen e stentave merrnin nga 500 (pesëqind) euro, ndërsa për koronarografi nga 150 (njëqindën e pesëdhjetë)euro,

Kolegji i Gjykatës së Apelit ka parasysht se gjykata e shkalles sa para na arsyet e aktgjykimit ka dhënë arsye lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike qe ta pandehurve u vihej ne barre si na pikën II, të dispozitivit.

Kolegji vlerëson se gjykata e shkalles së parë ka arsyetuar si për sa i përket provave dhe atë deklarave te dëshmitarëve, që janë proceduar ne shqyrtimin gjyqësor, gjegjësisht:

Dëshmitari A.O, në seancë të shqyrtimit gjyqësor të datës 15.11.2022 ka deklaruar se mbetet pranë dëshmisë së dhënë me datë 10.09.2019 dhe nuk ka çfarë të shtojë më tepër, përveç faktit se ndihet i dëmtuar në aspektin shëndetësor dhe moral dhe për këtë ka paditur MSH. Në shqyrtim gjyqësor ka theksuar se ai ishte pacient dhe përmend mjekun Masar Gashi si dhe faktin se ndihet si palë e dëmtuar dhe se paraqet kërkesë pasurore juridike.

Dëshmitari Sh.A në seancë të shqyrtimit gjyqësor të datës 15.11.2022 ka deklaruar se mbetet pranë dëshmisë së dhënë me datë 09.09.2019 dhe nuk ka çfarë të shtojë më tepër, përveç faktit se ndihet shumë i dëmtuar. Ne shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës së dhënë në prokurori me datë 06.11.2014, kishte përmendur babain e tij A... si pacient dhe mjekët Masar Gashi, Basri Sejdiu, Sami Gjoka dhe Bedri Zahiti, si dhe faktin se veten e konsideron palë të dëmtuar dhe parashtrohet kërkesë pasurore-juridike.

Dëshmitari A. U në seancë të shqyrtimit gjyqësor të datës 15.11.2022 ka deklaruar se mbetet pranë dëshmisë së dhënë në gjykatë me datë 09.09.2019, në vazhdim deklaron se në atë kohë në spital nuk ka patur stenta andaj e kishte dërguar nënën në spitalin turk, sërish thekson se nuk e konsideron veten të dëmtuar ngase i ka marrë mjetet nga MSH andaj edhe nuk parashtrohet kërkesë pasurore-juridike. Ne marrjen ne pyetje ne seancën paraprake ne shqyrtim kishte deklaruar se

mbetet pranë deklaratës të dhënë në prokurori me datë 03.02.2016, duke shtuar se pas shfaqjes së problemeve shëndetësore tek nëna e tij, të njëjtën e kanë dërguar në spitalin e Pejës, dhe pas kontrollit nga mjeku Sali Shala, iu është thënë se “direkt duhet me dërgu nanën në spitalin privat”, ka përmend dy spitale, atë turk dhe atë amerikan dhe me atë rast ia ka dorëzuar një letër të vogël ku kanë qenë të shënuar spitalet turk apo amerikan me numrat telefonik të doktorëve, mirëpo dëshmitari ka marr flet lëshimin e Spitalit të Pejës dhe nënën e ka dërguar në QKUK, ku kontrollën e ka bërë mjeku Rexhep Manaj, ku nga i njëjti i është thënë sa ka nevojë për vendosjen e stentës dhe i ka shpjeguar se QKUK nuk ka stenta, mirëpo që mund të bëjë kërkesë në MSH për kompensim të shumës së nevojshme, dhe ashtu ka vepruar, ka dorëzuar dokumentet e nevojshme në MSH, para vendosjes së dy stentave në spitalin turk, dhe që gjithë shumën e nevojshme prej 5300 euro ia ka paguar MSH. Ka pohuar se nuk e konsideron veten të dëmtuar dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike.

Dëshmitari N.D ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës së dhënë në prokurori me datë 21.01.2016, duke shtuar se në vitin 2012 pas shqetësimeve shëndetësore, ka shkuar në spitalin e shtetit në Pejë, ku është trajtuar nga mjeku Sali Shala, i cili e ka rekomanduar të qëndrojë në spital për shkak të gjendjes shëndetësore mirëpo i njëjti nuk ka vepruar sipas rekomandimit të tij dhe ka shkuar shtëpi, rreth orës 2 pas mesnate ka pësuar sulm- atak, ka shkuar përsëri në spitalin e Pejës, tek mjeku i njëjtë Sali Shala, i cili e ka sugjeruar me shkuar me bë një koronografi, por që mund të bëhet vetëm në dy spitale private në Prishtinë dhe në Gjakovë. Më tutje ka shtuar se ka shkuar në Spitalin Privat EDA, është takuar me mjekun Borçe Petrovski, i janë vendosur dy stenta, për të cilat ka paguar shumën prej 7000 euro, për koronografi ka paguar 859 apo 950 euro, ndërsa për katër ditët e qëndrimit ka paguar nga 150 euro. Ka deklaruar se veten nuk e konsideron si palë të dëmtuar dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike.

Dëshmitari B.H deklaron se ai kishte vendosur vet të dërgojë nënën në IMH për më mirë dhe atë me shpenzime familjare, sërish thekson se nuk e konsideron veten të dëmtuar dhe nuk parashtron kërkesë pasurore-juridike, tutje ka sqaruar se shtuar se nëna e tij si rrjedhojë e problemeve shëndetësore ka bërë ndërrimin e valvules së zemrës në Spitalin Privat IMH në Prishtinë, dhe për këtë ka paguar 7.500 euro. Para intervenimit nënën e tij e ka dërguar tek mjekë të ndryshëm, përfshirë edhe mjekun Sali Shala në Pejë, e të cilët i kanë pohuar në mënyrë të njëjtë, mirëpo që asnjëri prej tyre, nuk i ka thënë se në cilin spital duhet të shkojë, përveç që ndërrimi i valvulës është i domosdoshëm. Më tutje ka shtuar se i kujtohet se gjatë deklaramit të dhënë në prokurori, është ballafaquar me një SMS të dërguar nga Sali Shala për A. B, dhe me atë rast dëshmitari ishte përgjigjur “së pari Sali Shala, nuk ia ka dërguar dikujt në “IMH” numrin e nënës time”, e

që përsëri ka pohuar se asnjëherë asnjë mjek nuk e ka orientuar se në cilin spital apo mjek me shkuar. Nuk e konsideron veten palë të dëmtuar dhe nuk paraqet kërkesë pasurore juridike.

Dëshmitari I.S ka deklaruar se në MSH ka bërë kërkesë për kompensim edhe ankesë për harxhimet në QKUK, askush nga të akuzuarit nuk është shkaktar i demit përveç MSH. Pastaj thotë se ka shkuar edhe në Shkup ka bërë një stentë në vitin 2011-2012 dhe i ka kushtu 3.400 euro, sepse në QKUK nuk ka punuar koronarografia dhe se mjeku Daut Gorani e ka trajtu si me e pas vëlla, nuk e ka referu askund por ai vet ka shkuar në Shkup, por nuk ka bërë kërkesë në MSH për shumën e harxhuar në Shkup, tutje ka sqaruar se me datë 16.04.2012 ka ndje dhembje në gjokse, fillimisht është paraqitur në Shtëpinë e Shëndetit në Lipjan, ka marr udhëzim për të shkuar në QKUK dhe është pranuar në Repartin e Kardiologjisë, është kontrolluar nga Daut Gorani, i është bërë një ultrazë i zemrës, ndërsa që për koronarografi i është thënë se nuk punon aparati, dhe nuk i ka propozuar me shku dikund tjetër. Më tutje ka shtuar se pas katër dite, ka shkuar në Shkup në spitalin “Cistina”, ku është bërë edhe intervenimi dhe vendosja e një stente, mirëpo me datë 31.08.2013, pas një shtrengimi në gjoks, është paraqitur në QKUK-në Repartin e Kardiologjisë, ku mjeku Fisnik Hima, i ka thënë se me atë diagnozë duhet mu transferu në spitale private, dëshmitari ka kërkuar me u transferu në Shkup, mirëpo pa kaluar gjysme orë ka ardhur auto-ambulanca e spitalit privat turk, të cilën nuk e di se kush e ka thirr ka shku dhe pasi që është vendosur në atë spital i është bërë koronarografia dhe i janë vendos dy stenta, për të cilat ka paguar 5.800 euro. Pas një muaji me rastin e bërjes së një kontrolli në Shkup në spitalin “Sistina” i është thënë se për një stentë ke pas nevojë, për të dytën nuk ke pas nevojë fare. Dëshmitari është ballafaquar me pjesën e deklaratës së dhënë në prokurori me dt.12.11.2014 ku ka deklaruar “me dt. 31.08.2013 kam shku në kontrollë në Klinikën e Kardiologjisë në QKUK në Prishtinë ku ishte Fisnik Hima, i cili doktor nuk më ofroi kurrfarë trajtimi dhe në bisedë me të i thash se tani menjëherë do të nisem në klinikën Cistina për në Shkup, por i njëjti kundërshtoi dhe më udhëzoi që të shkojë në klinikën private IMH dhe është ardhur auto-ambulanca e kësaj klinike private të cilët më dërguan në këtë klinikë por nuk më kujtohet se kush e ka thirrur, dhe posa kam mbërri në këtë klinikë private në IMH, ku aty e takova dr.Edis Demirin dhe dr.Shpend Elezin të cilët pasi që ma realizuan një EKG më futën në sallë ku fillimisht është kryer një koronarografi dhe më pas mi kanë vendos dy stenta pa më pyetur fare. Pasi që jam dal prej sallës më kanë vendos në një dhomë ku në ato momente ka ardhur edhe vëllai im Shabani dhe më tregoj se për shërbimet mjekësore të cilët i kanë realizua sot duhet të paguani shumën prej 5.800 euro, pasi që këtë ia kishin kërkuar dr.E. D dhe dr.Sh. E dhe pas dy ditësh e kemi bërë pagesën në

shumën e lartë cekur”, është përgjigjur se kështu ka deklaruar, dhe se kjo është e vërtet. Vetën e konsideron palë të dëmtuar dhe parashtron kërkesë pasurore-juridike.

Dëshmitari M. H ka deklaruar se në vitin 2012 i janë paraqitur probleme shëndetësore, andaj me datë 29.10.2012 është paraqitur në Spitalin e Prizrenit, në urgjencë, është kontrolluar nga mjeku Shemsedin Shabollari, i cili edhe ka konstatuar se ka pasur infarct, pastaj nuk i kujtohet se si ka shkuar në Spitalin Privat EDA, mirëpo që pas ballafaqimit me deklaratën e dhënë në prokurori me datë 25.01.2016, ku kishte deklaruar se “në Prizren ku më ka kontrollu mjeku Shemsedin Shabollari, dhe pas analizave e kanë pa se e kisha tensionin shumë të lartë dhe në bazë të EKG ata kanë parë se unë kam infarkt dhe më kanë thënë se duhet të shkoj në spitalin privat EDA për të intervenuar për çka unë kam edhe dokumentin fletëdaljen e spitalit në Prizren... dikush e ka thirrur atë spital privat dhe me atë veturën e tyre, kanë ardhur dhe më kanë marr në Prizren”, ka pohuar se kjo është e vërtetë, kështu ka deklaruar. Më tutje ka shtuar se në këtë spital ka shkuar me veturën e ndihmës së shpejtë dhe pasi që ka arritur në spitalin privat EDA, është bërë kontrolli dhe koronarografia, siç konstatohet edhe në dokumentetacionin mjekësor, është bërë një stentim dhe një pastrim i kanalit, për çka ka paguar shumën prej 4.000 euro. Ka shtuar se nuk e ka ditur se ekziston mundësia për me bë kërkesë për kompensim nga MSH, dhe as tani nuk paraqet kërkesë për kompensim meqenëse nuk e konsideron vetën të dëmtuar.

Dëshmitari A.B në shqyrtim gjyqësor fillimisht ka deklaruar se për nënën kishin paguar 4.000 euro për stentim por nëna i kishte vdekur, kërkesë kishte bërë në MSH por u ishte refuzuar kërkesa, tani ndihet i dëmtuar ai ka sqaruar se nëna e tij ka pasur problem me tension dhe zemër, me dt.25.09.2014 pasi është dërguar në Qendrën Familjare në fshatin “Bresje”, është konstatu se ka pësuar infarkt, pastaj me ndihmën e shpejtë është dërguar në QKUK në Prishtinë, pas një kontrolli i është kërkuar që t’i bëjnë një analizë në spitalin privat Amerikan ku edhe ka shkuar dhe i kanë thënë se nëna e tij nuk ka pësuar infrakt, mirëpo pas 3 ditësh i janë paraqitur përsëri probleme me zemër, e ka dërguar te mjeku Kelmend Pallaska në ordinancën e tij private, ku i njëjti ka konstatuar se nëna e tij ka pësuar dy sulme dhe duhet të shtrihet në QKUK. Më tutje ka shtuar se duke vepruar sipas rekomandimeve të Kelmend Pallaska, nënën e kanë dërguar në QKUK-në Repartin e Kardiologjisë ku ka qëndruar 3 ditë, e më pastaj është njoftuar se i është keqësuar gjendja shëndetësore, për çka dëshmitari së bashku me familjar të tjerë ka shkuar në QKUK, është takuar me mjekun Fisnik Hima, i cili ka qenë mjek kujdestar dhe dr.Nexhmi Zeqiri, dhe të dytë i kanë thanë se në këtë rast nuk mundën me bë asgjë dhe duhet me e transferu në spital privat turk IMH, e të njëjtit edhe e kanë thirrur ndihmën e shpejt të këtij spitali, me të cilën është dërguar nëna e dëshmitarit, aty i kanë njoftu se tek nëna duhet me bë koronarografi, për të

cilën duhet të paguhen 700 euro, dhe se duhet me pritë 40 minuta deri sa të merret rezultati, mirëpo pas 5 minutave ka dal mjeku dhe ka thanë gjithqysh duhet me u operu, për shkak se dy damarë të zemrës i ka të mbyllura, duhet me vendos një stentë, e pastaj stentën e dytë duhet me vendosë pas dy muajve, sepse nuk guxojnë me bë stentimin menjëherë, koronarografia së bashku me stentën ka kushtuar 4.000 euro, mirëpo gjendja shëndetësore e saj nuk ka qenë e mirë edhe me dt.04.10.2014 ka ndërruar jetë derisa ka qenë në spital ai ka sqaruar se veten e konsideron të dëmtuar dhe paraqet kërkesë pasurore juridike.

Dëshmitari S.R ka deklaruar se në vitin 2014 ka pasur probleme me zemër, dhe është paraqitur për kontroll në spitalin e Gjilanit, i është bërë një EKG, ndërkohë ka ardhur mjeku Agron Leka, i cili i ka rekomanduar që pas dy javëve përsëri të paraqitet për kontroll, mirëpo që dëshmitari pas dy - tri ditëve me insistim të familjarëve të tij ka realizuar një kontrollë në ordinancë private të mjekut Besim Guda në Gjilan, i cili i ka propozuar që në spitalin e Gjilanit t'i bëj analizat detale por dëshmitari nuk ka shkuar, mirëpo në ndërkohë, me sygjerimin e një miku të tij Abdyleqim Bejtullahu ka shkuar në spitalin turk IMH në Çagllavicë, me ç'rast pas kontrollit të bërë nga mjeku Mahmut Qakmak, i është thënë që duhet t'i vendos dy stenta. Më tutje ka shtuar se koronografinë e ka bërë në muajin prill, ndërsa vendosja e stentës është bërë në muajin korrik apo gusht, për çka ka paguar 5.100 euro, e që lidhur më këto rrethana është ballafaqur me deklaratën e dhënë në prokurori me datë 02.02.2016 ku ka deklaruar se "Po, kam pasur një problem me zemër në vitin 2014, kam shku në spitalin Regjional të Gjilanit për kontrollë ku më ka kontrollu mjeku Agron Leka, por ai nuk më ka preferu ti bëj disa analiza, unë nuk e kam parë më kurrë Agron Lekajn, pastaj kam pas një kontrollë tek dr.Besim Guda dhe ai më ka thënë, se ke nevojë të bësh një koronarografi dhe, ka thënë se, nese ke mundësi mund të drejtohesh edhe në QKUK por duhet të kesh ndonjë lidhje e poashtu mund të shkosh edhe në spitalin privat IMH, me këtë rast ka pohuar se kjo është pjesërisht e vërtetë, e çka është ndryshu nuk e di, mirëpo që nënshkrimin në deklaratën në prokurori e ka pranë si të vetin. Pastaj dëshmitarit po ashtu i është lexuar ballafaqimi i bërë në prokurori, me një SMS të datës 21.10.2013 rreth orës 13:13, i cili është dërguar nga mjeku Daut Gorani tek Astrit Bakqi, ku shkruan "Skender Ramadani, a e njihni dr.Daut Goranin", mirëpo dëshmitari është përgjigjur se nuk i kujtohet duke mohuar në të njëjtën kohë se është kontrolluar në QKUK tek Daut Gorani, apo Astrit Bakiqi. Më tutje ka shtuar se nga MSH është kompensuar deri në 70% të shumës së paguar në spitalin IMH, dhe nuk e konsideron veten të dëmtuar dhe nuk paraqet kërkesë pasurore juridike.

Dëshmitari N.H ka deklaruar se në vitin 2015 babai i tij ka pasur probleme shëndetësore, ashtu që derisa ka qenë në shtëpi ka pas infarkte dy here, ndërsa infarktën e tretë e ka pësuar derisa ka

qenë në QKUK në Prishtinë, për çka është vlerësuar nga grupi i mjekëve se i njëjti duhet me u shëruar jashtë QKUK-së, dhe me këtë rast i është lëshuar letra referuese e datës 19.01.2015 e nënshkruar nga tre mjekë, dhe drejtori i klinikës Gani Bajraktari. Më tutje ka shtuar se është interesuar se në cilin spital ta dërgojë babain e tij, ka vendosur t'a dërgojë në spitalin "IMH" ku për kryerjen e ndërhyrjes është dashur të paguaj 5.500 euro, shumë të cilën është dashur t'a paguajë para se të fillon ndërhyrja. Po ashtu ka shtuar se pas kërkesës së paraqitur MSH ka vendosur që t'ia kompensojë shumën prej 4.900 euro në bazë të pro faturës për spitalin IMH, mirëpo fillimisht spitali IMH ka refuzuar që dëshmitarit t'ia kthejë shumën e paguar deri në vlerën e kompensuar nga MSH dhe pastaj, ka pranuar t'ia kthejë shumën prej 3.500 euro. Ka deklaruar se e konsideron veten të dëmtuar dhe paraqet kërkesë pasurore-juridike.

Dëshmitari B.A ka deklaruar se, me datë 23.02.2012 ka pasur probleme shëndetësore me zemër, ashtu që është paraqitur në Spitalin Rajonal të Pejës, ku mjek kujdestar ka qenë mjeku Elfedin Muhaxheri, të cilin e ka njohur edhe më herët, e ka kontrolluar, i ka bërë EKG-në dhe një fotografim të gjoksit, si edhe i kanë vendosur katedrën, ani pse ka thënë se nuk ka pasur nevojë për këtë, për çka edhe i ka humbur vetëdija, ndërsa pas kthimi të vetëdijes, mjeku Elfedin Muhaxheri është afruar dhe e ka pyetur se "a po doni me shku në spitalin në Prishtinë...apo në spital në Gjakovë", gjë që dëshmitari ka pranuar, pastaj Elfedini e ka thirr auto-ambulancën, me të cilën është dërguar në spitalin EDA, pastaj fillimisht i është vendosur një stent, dhe më vonë edhe stenta e dytë, ashtu që në spital ka qëndruar tri ditë. Sa i përket pagesave, dëshmitari ka theksuar se kur është pranuar në spitalin EDA, familjarëve të tij mjeku Brovina i ka kërkuar shumën prej 14.500 euro për vendosjen e stentave, mirëpo më vonë ka zbritur në 10.500 euro, e të cilën shumë ka dëgjuar se është përmendur edhe gjatë intervenimit për vendosjen e stentës së parë nga mjeku Blerim Zuna, e që lidhur me këtë rrethanë i është rikujtuar deklarata e dhënë në prokurori ku ka deklaruar se "në atë moment ka ardh doktori djali i mjekut Broche Petrovski i cili më ka thanë " to te nece boliti i nemoj da se plasis" më kanë futur telin e kamerave në dorën e djathë dhe në shikimin e parë në ekran Blerim Zuna i ka thanë djalit të Broche Petrovski 10.000 euro. Ai ka mendu se unë jam pa vetëdije dhe ka dal jashtë ka bisedu me djemtë e mi, me vëllaun tim Sezahirin dhe iu ka thanë se duhen 13.500 euro...kur mi kanë vendos këto dy stentat e tjera kanë vepru njëjtë sikurse pas dy stentave të para, pas tri ditëve mjeku Lulzim Brovina më ka ardhë në dhomën time në spital dhe më ka thanë 'Bujar ki nevojë edhe për një stentim pas shpine por ajo bëhet pas gjashtë muajve, kam dal nga spitali dhe djemtë e mi i kanë paguar 10.400 euro për këto katër stenta", ka deklaruar se kështu ka deklaruar duke shtuar se edhe pse fillimisht i është thënë se vendosja e stentës ka me qenë falas nga mjeku Lulzim Brovina, kur ka shkuar për

stendim, është detyruar t'i paguajë 3.000 euro, për çka edhe posedon dëshmi faturën e pagesës. Më tutje dëshmitari pasi që ka pohuar se nuk është kontrollu në QKUK, është ballafaquar me një letër referuese në emrin e dëshmitarit B.A të lëshuar nga QKUK-Klinika e Kardiologjisë, me diagnozë “gjendje pas stentimit”, dhe konstatimit “të vendoset nga Komisioni i MSH-së”, ku në fund janë nënshkrimet e tre mjekëve të komisionit konziliar për kardiologji në përbërje prej Hajdin Qitaku, Daut Gorani dhe Agim Krasniqi, e cila mbanë datë 04.07.2013 dhe në fund ekziston nënshkrim i Drejtorit të Klinikës Bedri Zahiti e protokoluuar me nr.554 datë 04.05.2013, për çka përsëri ka mohuar të jetë kontrolluar në QKUK. Po ashtu ka shtuar se ka kërkuar kompensim prej MSH, mirëpo është refuzuar për shkak se nuk ka qenë paraprakisht në spitalin e QKUK-së në Prishtinë, e konsideron veten të dëmtuar dhe paraqet kërkesë pasurore juridike, pasi që është dëmtuar në shumë totale rreth 16.800 deri 17.000 euro.

Dëshmitari Sh.Sh ka pohuar se fillimisht është dërguar në spitalin e Vushtrrisë në Emergjencë, pastaj sipas udhëzimit në Vushtri është dërguar në QKUK në Prishtinë, në një nga dhomat e Repartit të Kardiologjisë ku është kontrolluar nga mjekët, përfshirë mjekun Masar Gashi, i cili i është drejtuar me fjalët se pacientja Fatime Shala e ka gjendjen e rëndë, duhet me dergu dikun tjetër sepse nuk mund të trajtohet në QKUK, se janë dy spitale këtu në rrugën për Ferizaj, dhe ja ka dhënë numrin e spitalit privat EDA. Nëna e dëshmitarit, është dërguar në spitalin privat EDA, është futur në sallën e operacionit dhe pas 15 minutave ka dalur dr.Lulzim Brovina iu ka thënë se ka një ngushtim, dhe duhet me vendos një stentë, që me koronargrafi së bashku kushton 4.000 euro, ndërsa pas dy ore ka dal përsëri i njëjti, së bashku me një mjek Maqedoni i kanë thënë se janë edhe tri ngushtime të tjera që duhet me intervenu, e që duhet paguhet shuma prej 11.000 euro, por ia kanë heq 1.000 euro dhe dëshmitari ka paguar 10.000 euro, nga të cilat 7.000 euro i ka paguar kesh, ndërsa shumën 2.500 euro e ka pagu përmes bankës. Ka pohuar se e konsideron veten të dëmtuar, pasi që është dashur të marr kredi 10.000 euro, për të cilat edhe ka paguar kamat, andaj edhe parashton kërkesë pasurore juridike.

Dëshmitari Xh. P ka deklaruar se vëllai i tij M. P i moshës 56 vjeçare në janar të vitit 2014, si rrjedhojë e problemeve me zemër, është shtrirë në QKUK në repartin e zemrës dhe nga shefi i repartit të mjekut Masar Gashi i është thënë se vëllain e tij duhet me dërguar në spitalin privat EDA, ku punon mjeku Lulzim Brovina, ka biseduar me të njëjtin e pastaj edhe ka ardhur autoambulanca e këtij spitali për ta dërguar në spitalin EDA. Më tutje ka shtuar se në momentin kur vëllain e tij e kanë futur në operacion i është thënë nga mjeku Blerim Zuna, se 90% vëllai ka me u shërua, pastaj kanë lidhur një kontratë për kryerjen e pagesës, mirëpo që rreth orës 01:00 të mesnatës nga i njëjti i është dhënë lajmi se vëllai i tij ka ndërruar jetë, por që për trajtimin që

i është bërë në këtë spital, ka paguar shumën prej 4.000.00 euro. Vetën e konsideron palë të dëmtuar dhe paraqet kërkesë pasurore juridike.

Dëshmitarja F. K ka deklaruar se ajo ishte paciente dhe ka përmendur mjekun Masar Gashi ndërsa nuk është deklaruar për kërkesë pasurore juridike.

Dëshmitari i dëmtuar A. N kishte deklaruar se në vitin 2011 babai i saj ka pasur dhimbje në gjoks, për çka është dërguara në Emergjencë në Gjakovë, i është bërë një EKG dhe është konstatuar se ka pësuar një sulm në zemër, pastaj të nesërmen pas qëndrimit në spital gjatë natës, është kontrolluar nga mjeku Luan Pazhari, i cili iu ka thënë se duhet me shku në ordinancën e tij private me ba EHO-n e zemrës sepse në spitalin e shtetit, dhe për këtë kanë paguar 50 euro, pastaj Luan Pazhari kishte shkuar më shumë se një herë në dhomën e prindit dhe e kishte pyetur se ku e ke djalin-fjala ka qenë për dëshmitarin, dhe në bisedë me dëshmitarin, të njëjtit i është thënë se babai i tij e ka gjendjen e keqe, dhe duhet me dergu me ba koronargrafinë në spitalin EDA, me autoambulancë të Shtëpisë së Shëndetit për të cilën duhet t'i paguaj 100 euro, dëshmitari ka pas hamendje por ka pranuar që ta dërgojë në atë spital, ku për koronargrafi ka paguar shumën prej 1.000 euro, ndërsa për vendosjen e dy stendave ka paguar gjithsej 3.000 euro. Lidhur me këtë rrethanë është ballafaquar me deklaratën e dhënë në prokurori ku kishte deklaruar se “më tha se duhet ta dërgoj babanë tim në Prishtinë në spitalin privat EDA dhe mi ka kërkuar edhe 100 euro nëse doni me dergu me ambulancë të spitalit, por unë nuk i thash se më duhet fatura po që se ju paguaj dhe pastaj ata e dërguan me auto-ambulancë për të cilën pagova 100 euro”, është përgjigjur se është e vërtet që dr.Luan Pazhari ka kërkuar nga ai 100 euro për me dërguar babën me auto-ambulancën e spitalit, e që gjatë dërgimit me qenë edhe ai vet prezent. Më tutje ka shtuar se pas intervenimit dhe vendosjes së stentave, përsëri babai i tij ka pasur problem me zemër, fillimisht është dërguar në spitalin e Gjakovës, ku është konstatuar se duhet të vendosen edhe disa stenta, sepse i janë mbyllur të gjitha arteriet e zemrës, pastaj është dërguar në spitalin EDA për me vendos stenta tjera, i është bërë për stentimi, mirëpo që të nesërmen në ora 09:30 të mëngjesit ka ndërruar jetë, e që për tri ditë të qëndrimit në spital ka paguar 750 euro, ndërsa më vonë mjeku Lulzim Brovina i ka kërkuar edhe 2.000 euro për intervenimin që e ka bërë. E konsideron vetën si palë të dëmtuar.

Dëshmitari D. B kishte deklaruar se në vitin 2016 bashkëshortja e tij ka pasur problem me zemër dhe për këtë është dërguar në Spitalin Rajonal në Gjakovë ku është kontrolluar nga mjeku Luan Pazhari, dhe ka rekomanduar se duhet me u lajmëru në Prishtinë te dr.Lulzim Brovina, të cilin dëshmitari ka theksuar se e ka mik shtëpie, pastaj vetë dëshmitari e ka përzgjedh spitalin, ku ka

punuar edhe mjeku Lulzim Brovina, me të cilin paraprakisht ka bisedu përmes telefonit dhe me autoambulancën e spitalit EDA është dërguar bashkëshortja e tij në atë spital, ku i është bërë koronargrafia për të cilën ka paguar 700 apo 750 euro, është konstatu se çdo gjë është në rregull sa i përket zemrës. Dëshmitari është ballafaquar me pjesën e deklaratës së dhënë në polici me datë 02.02.2016, “dua të sqaroj se gruaja ime është dyshuar se në vitin 2012 ka problem me zemër, unë e kam dërguar në Spitalin e Gjakovës për një kontroll, aty kishte qenë si mjek në njësinë koronare mjeku Luan Pazhari, ku pas një kontrolli na sugjeroje që me urgjencë ta dërgojmë në spitalin e zemrës tek Maqedoni. Mjeku Luan Pazhari, na siguroi auto ambulancën me të cilën e dërguam në Prishtinë”, është përgjigjur se vetë e ka marr vendimin për me qu në kontroll atje, se e ka nënshkruar deklaratën pa e lexuar fare, dhe se e vërteta është ajo që ka deklaruar sot. Ka pohuar se nuk e konsideron vetën si palë të dëmtuar dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike.

Dëshmitari L. Q kishte deklaruar se në vitin 2013 nëna e tij nuk ka qenë mirë me shëndet, për çka edhe është dërguar në spitalin e Prizrenit, ku është kontrolluar nga mjeku Halim Halili, i është bërë një EKG e zemrës, ndërsa që dëshmitari ka biseduar me Halim Halilin i cili i ka shpjeguar se nëna e tij ka problem me zemër dhe nëse i ke mundësitë duhet me e dërgu në spitalin Turk ose Amerikan. Më tutje ka shtuar se nëna e tij është dërguar në spitalin Turk, me ambulancën e këtij spitali të cilën e kishte thirrur Halim Halili, ku pas incizimit të bërë, iu është thënë se nuk është urgjente për vendosjen e stendave, por nëse i kanë kushtet dhe dëshirojnë munden me ia vendos stendat dhe në këto rrethana, e në mungesë të kushteve ekonomike, kanë vendosur të mos i vendosin stenat, ndërsa që për incizimin e bërë-koronar grafinë kanë paguar shumë prej 700 euro. E konsideron veten palë të dëmtuar, mirëpo nuk paraqet kërkesë pasurore-juridike.

Dëshmitari I. M në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 27.12.2019, ka theksuar se rreth 7 vite me parë ka pasur problem me zemër, ashtu që ka shkuar në Spitalin e Prizrenit, aty është kontrolluar nga një mjek i gjatë, i shëndoshë, i zi dhe nuk ka ditë me fol mirë shqip, ka mujt me qenë turk ose goran, është konstatu se i ka damarët e mbyllur dhe pa i bërë kurrfarë fotografimi, e kanë thirr veturën e spitalit, ani pse dëshmitari nuk e dinë se kush e ka thirr dhe e kanë dërguar në spitalin EDA ku ka qëndruar tri ditë, i është bërë pastrami i damarëve dhe i janë vendosur stentat dhe për të gjithë shërbimin e marrë ka paguar shumë para kesh 6.800 euro. Më tutje dëshmitari është ballafaquar me pjesë të deklaratës së dhënë në polici me datë 03.02.2016 ku në pyetjen se “Gjatë kontrollit që ju ka bë mjeku, çka ju ka thënë ai, a ju ka referu, apo ju ka dërgu në spitalin privat IMH apo EDA”, ishte përgjigjur “Po, mjeku më ka thanë se duhet të shkoni në

ndonjë spital privat të zemrës dhe mundë të shkoni në Prishtinë apo Tiranë, unë thash kisha dashtë të shkoj më afër në Prishtinë, mjeku e ka thirr një auto-ambulancë të spitalit privat dhe afërsisht pas 1 ore ka arrit auto-ambulanca me të cilën jam transportu në spitalin EDA në Prishtinë...., më kanë vendos dy stenta dhe për këtë kam paguar 5.600 euro”, për çka ka pohuar se kështu ka deklaruar, se ka paguar 6.800 euro, e për këtë e posedon faturën si dëshmi për pagesë për shërbim në spitalin privat EDA. E konsideron vetën palë të dëmtuar dhe parashtron kërkesë pasurore juridike.

Dëshmitari Q. Y në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 27.12.2019 kishte deklaruar se, rreth 5-6 vjet ma herët ka ndjerë shtrëngim dhe dhimbje në gjoks, ka shkuar fillimisht në spital në Prizren, e pastaj nga familjaret e tij, është dërguar në një spital privat në Prishtinë me auto-ambulancë, për të cilën nuk e ka ditur a ka qenë privat apo e shtetit, i janë vendosur dy stenta, dhe për këtë ka paguar shumë prej 6000 euro. Lidhur me këto rrethana është ballafaquar me pjesën e deklaratës së dhënë në Prokurori me datë 25.01.2016, ku ka deklaruar “Po kam qenë i sëmurë, dhe kam shkuar në Spitalin Rajonal të Prizrenit tek mjeku Shemsedin Shabollari dhe aty mjeku më ka thënë se kam infarkt, dhe se duhet të shkoj urgjent për Prishtinë, por vajza ime Suada ka thënë se unë nuk dua ta dërgoj babën tim në Prishtinë por në Shkup, por mjeku Shemsedini këmbënguli që të shkoj në Prishtinë, duke më thënë se nëse niset për Shkup ki me hup babën se mundet rrugës me vdekë dhe pas këtyre fjalëve djali im dhe vajza ime vendosen me më dërgu në Prishtinë” me ç’rast ka deklaruar se këto fjalë nuk i din, ata kanë vendos sa ma shpejt me më dërgu në Prishtinë, nënshkrimin në deklarata e ka pranuar si të vetin, por që ka theksuar se nuk e ka lexuar se nuk dinë mirë shqip. Po ashtu ka shtuar se nga vendosja e stentave, nuk ka pasur me problem me zemër, dhe pas kontrolleve të kryera edhe në Shkup është konstatu se i janë vendosur dy stenta dhe gjendja e tij shëndetësore është e mirë. Vetën nuk e konsideron palë të dëmtuar dhe nuk paraqet kërkesë pasurore juridike.

Dëshmitari H.K, nder te tjera ka deklaruar se me date 15.08.2012 ka pas sulm-atak në zemër, ka shkuar në Spitalin Rrgjional në Gjilan-Reparti i Koronarografisë, aty është kontrolluar nga mjekët Ismajl Aliu, Agron Leka dhe Besim Guda, ka qëndruar në spital, ku i janë bërë analizat, nga të cilat është konstatuar se ka pësuar atak në zemër, mirëpo me datë 17.08.2012 pas bisedës që ka pasur me mjekët Agron Lekën, me Ismajlin dhe Besim Guda, Agron Leka ka shkuar te shtrati i tij dhe i ka thënë se duhet me bë koronarografinë, të cilën duhet t’a bëjë në spitalin privat IMH në Llapnasellë, ndërsa mjeku Ismajli i ka propozuar me shku në Shkup në spitalin “Filipi II”. dëshmitari kishte vendosur që të shkojë në spitalin IMH, ka ardhë auto-ambulanca e ndihmës së shpejtë, të cilën e ka thirrur mjeku Agron Leka ndërsa ia vet ka qëndruar në veturën e djalit

të mixhës i cili ka shkuar pas autoambulances, koronar grafia është bërë nga mjeku Shpend Elezi, pastaj i janë vendosur dy stenta, për të cilat ka paguar shumën totale prej 5.300 euro, për ato pagesa i posedon dëshmitë. Më tutje ka shtuar se kërkesë për kompensim në MSH nuk ka bërë, për shkak se më vonë ka kuptuar se ekziston mundësia për kompensim, por edhe për arsye se mjeku Agron Leka në flet lëshim ka konstatuar që “Pacienti transferohet në qendër tjetër me insistimin e familjarëve të tij” e të cilin fletlëshim e ka pranuar pasi është trajtuar në spitalin privat IMH, ku është bërë edhe vendosja e stentave, lidhur me këtë fakt ka pohuar se ka biseduar me mjekun Agron Leka, duke pyetur se pse nuk ja ka dhënë udhëzimin për te shkuar në QKUK në Prishtinë, mirëpo që ai i është përgjigjur se “pse me ta dhanë, ti nuk e ke kërkuar, ti ke kërkuar për te shkuar në spitalin privat”. E konsideron vetën të dëmtuar materialisht dhe moralisht, dhe parashtron kërkesë pasurore-juridike.

Dëshmitari Sh.H ka deklaruar se për shkak të ankesave me frymëmarrje, ka shkuar në QKUK, ku është kontrolluar nga mjeku, Lulzim Kamberi, pas bërjes së ekzaminimeve (ergometria – me ecë në trakë) ka konstatuar se ka nevojë për koronargrafi meqë i janë bllokuar damarët e zembrës dhe duhet të vendos stenta, dhe për këtë duhet të paguajë 700 euro, mirëpo pasi të rregullohet aparati, ndërsa që tani për tani, stentimi nuk mundet me u kry në QKUK. Më tutje ka shtuar se pas dy javëve, është paraqitur përsëri në QKUK, me ç ‘rast mjeku Lulzim Kamberi i ka thënë me shku nesër në ora 10:00 në spitalin turk, e që dëshmitari ka vepruar ashtu, ka shkuar në spitalin turk, ku është takuar me mjekun Lulzim Kamberi dhe menjëherë është dërguar në sallë ku i është vendosur një stent dhe për këtë i janë kërkuar 2.200 euro, me ç ‘rast i është dhënë një CD, e cila ka rezultuar e zbrazët, e që më kërkesën e tij, i është dorëzuar edhe një CD tjetër, të cilën asnjëherë nuk ka tentuar ta përdorë. Po ashtu dëshmitari edhe pas ballafaqimit me pjesën e deklaratës të dhënë në prokurori me datë 28.10.2014, ku ka deklaruar se “Unë nuk i kisha ato para, dhe dola i kërkoja nëpër tregtarë duke e qitur peshqirin para xhamisë për t’i mbledhur 800 euro dhe pastaj Lulzimi më tha të shkojë në spitalin EDA ku unë shkova me dy vëllezërit e mi, aty mi bënë analizat dhe më dërguan në sallë dhe aty erdhi edhe dr. Lulzim Kamberi, aty më shikuan me një aparat dhe më thanë se e ke një damar të mbyllur 95 % e tjetrin 40 – 50 %, dhe për mos me tu mbyllë, a e ke ndokënd jashtë dhe pasi unë i thash se i kam vëllezërit jashtë ata dolën e folën me vëllezërit e mi dhe atyre u thanë se çmimi për një stentë kushton 3.500 euro, por e zbritën çmimin në 2.500 euro dhe vëllezërit u pajtuan dhe ata ma vendosën stentën”, është përgjigjur se po ashtu ka deklaruar. E konsideron veten si palë të dëmtuar dhe parashtron kërkesë pasurore-juridike.

Dëshmitari L.E, ka deklaruar se me datë 05.06.2013 babai i ti ka qenë e sëmur, fillimisht e kanë dërguar në Shtëpinë e Shëndetit në Lipjan, e pastaj sipas udhëzimit në QKUK në Prishtinë, ku ka qëndruar deri me datë 11.06.2013. Më tutje meqenëse dëshmitarit nuk i është kujtuar se nga kush është kontrolluar prindi, është ballafaquar me flet lëshimin me nr të protokollit 2736, të nënshkruar nga ana e mjekut të dhomës Fisnik Hima, Hajdin ..., dhe mjekët Ejup Pllana dhe Bedri Zahiti, që në fund është shënuar pacienti lëshohet në gjendje të përmirësuar me rekomandim që t'a përdor terapinë, me ç'rast ka deklaruar se para se të lëshohet nga spitali i QKUK-së, sa i kujtohet një teknik medicinal me mbiemrin Fisnik, ka insistu që nënën ta dërgoj në spitalin internacional IMH, se gjithqysh duhet mi vendos stentat, nuk lihet prindi të vdesë për shkak të parave dhe pastaj ka ardhë ambulanca e spitalit IMH, të cilën nuk i është kujtuar se kush e ka thirrur, në IMH i është bërë kornarografia dhe i janë vendosur katër stenta, për të cilat ka paguar shumë prej 6.100 euro, për këtë e posedon edhe dëshminë – faturë për pagesën që e ka bërë me para kesh. Më tutje ka shtuar se babai i tij nga spitali ka dalë me datë 11.06.2013, pastaj me datë 18.06.2013 ka pësuar sulm në zemër dhe gjatë dërgimit për në spitalin privat IMH, ka ndërruar jetë, ndërsa që sqarimi mjekut se deri te përkeqësimi ka ardhur si rrjedhojë e mos përdorimit të terapisë, i është dukur i paqëndrueshëm. E konsideron veten të dëmtuar dhe paraqet kërkesë pasurore juridike.

Dëshmitari Sh.B kishte deklaruar se, djali i tij Kushtrim Ballazhi ka pasur probleme shëndetësore, ashtu që fillimisht është paraqitur në Shtëpi të Shëndetit në “Han të Elezit” ku ka bërë EKG-në, pasi është dyshu se ka diçka në zemër, pastaj është dërguar në Spitalin e Ferizajit, mirëpo i është rekomanduar që djalin ta dërgojë në QKUK në Prishtinë ashtu edhe ka vepruar, në QKUK, në Repartin e Kardiologjisë, kujdestar ka qenë mjeku Lulzim Kamberi të njëjtin e ka identifikuar edhe në sallën e gjyqimit, i cili i ka thënë se “djali punët i ka shumë keq, e ka zemrën katastrofë, në bazë të EKG, zemra është shumë keq, me më ndëgju mu nëse i ke xhepat plot, e të jesh i fortë, e qon tek Spitali Turk në magjistralen Prishtinë – Ferizaj” gjykatës ia ka prezantuar një letër të cilën i'a kishte dhënë i njëjti, me një numër të telefonit të shkruar “044/145-680, poshtë numrit është shënuar Luli, e pastaj, Artori – B 100, pastaj 3-4,-3-3 dhe 3, të njëjtës i është shtuar një letër e vogël në të cilën është shënuar numri 038/500-601, paoshtu me tekst “indikohen të bëhet TEE”. Më tutje ka shtuar se duke vepruar sipas rekomandimit të mjekut Lulzim Kamberi, ka shkuar në spitalin turk, në oborrin e të cilit kanë qenë duke e pritur dy infermjere, kanë filluar me kontrollu dhe se për bërjen e koronarograsisë i ka paguar shumë prej 740 apo 750 euro, mirëpo që është konstatu se djali nuk ka kurgjo, pastaj ka biseduar me Lulzimin, i cili i ka thënë se duhet me shku në Fushë Kosovë në ordinancë për me shti një kamerë në zemër ose

me shku në klinikën ‘Eromedika’ në Klllokot, dëshmitari ka vendosur t’ a dergojë në klinikën “Eromedika” në Klllokot, ku ka paguar 170 euro e që është konstatu se Kushtrimi ka një cistë mbrapa zemrës, mirëpo pas kontrollit nga mjeku Bosko Stavrevski, i njëjti ka konstatuar se Kushtrimi ka problem me zorrë, më tutje ka shtuar se me rastin e kryerjes së kontrollit në QKUK, nuk i është dhënë letër referuese, ndërsa e konsideron veten palë të dëmtuar dhe paraqet kërkesë pasurore juridike.

Dëshmitari T.G në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 25.10.2019 kishte deklaruar se, pasi që nuk është ndier mirë me shëndet, është paraqitur në Emergjencë-QKUK, ku një nga mjekët kujdestar të cilin dëshmitari e ka përshkruar si pllavush, e ka pyetur djalin e dëshmitarit se “si i ka kushtet...këtu nuk mundet mu ba kurgjo”, pastaj është dërguar në spitalin turk, ku në emër të vendosjes së dy stentave, ka paguar shumën prej 4000 euro. Më tutje ka shtuar se intervenimi është kryer nga mjeku Shpend Elezi, dhe dy doktorë tjerë, mirëpo përkundër intervenimit, ka vazhduar të këtë dhimbje në gjoks për çka edhe është dashur të paraqitet në QKUK, ndërsa pas 3-4 muajve, ka shkuar privatisht tek mjeku Ejup Pllana i cili i ka thënë se e ka të vendosur vetëm një stende. Tutje ka theksuar se kur jam kontrolluar mjeket Sami Gjolka dhe Irfan Dallaxhiu kanë konstatuar se unë kam te vendosur vetëm një stendë dhe pse me kanë thënë se nuk kam pasur fare nevojë për vendosjen e stendës, poashtu ka theksuar se e ndjen veten te dëmtuar.

Dëshmitarja, V. P ka theksuar se e njëjta ka dërguar nene e saj ne mjekim tek Mjeku Nexhmedin por te nesërmen e njëjta kishte ndërruar jete, ndërsa dëshmitari Sabri Kelmendi ka deklaruar se ne vitin 2013 ishte trajtuar nga mjeket, Reshat Emra dhe Elfedini ne Spitalin rajonal te Pejës dhe se ky dëshmitar ka deklaruar se e ndjej veten te dëmtuar dhe paraqet kërkesë pasurore juridike. Ndërsa dëshmitari L.Rr ka deklaruar se nena e tij si paciente për sëmundje zemre ishte trajtuar nga mjeku Reshat Emra, poashtu ka theksuar se e konsideron veten të dëmtuar dhe parashtron kërkesë pasurore-juridike.

Dëshmitarja Z.B kishte deklaruar se, pas problemeve me zemër, ka shkuar për kontroll në ordinance private të mjekut Halim Halili, i cili e ka rekomanduar që të shkoj në Spitalin e Prizrenit, ku përsëri është kontrolluar nga i njëjti mjek, dhe pas bërjes së analizave, nga i njëjti i është thënë se nëse nuk shkon brenda dy ore me ngjit stentat mund të vdesë, pastaj e ka thirr në telefon mjekun Arton Beqirin i cili punon në spitalin turk dhe i njëjti së bashku me dy persona tjerë kanë shkuar dhe me ambulancë e kanë dërguar në spitalin turk. Më tutje ka shtuar se vendosja e dy stendave dhe dy balonave është bërë nga mjeku Shpend Elezi, dhe për këtë ka paguar 5.300.00 euro, ndërsa që pas shkuarjes në kontroll, i është thënë se duhet ta vendos edhe

një stent, por që nga një mjek që ka punuar në atë spital me mbiemrin Demiri, i është bërë me dije se nuk ka nevojë për vendosje të stendës. Po ashtu ka shtuar se kërkesë në MSH nuk ka bërë, ndërsa e konsideron veten të dëmtuar nëse nuk i janë vendosur stenda dhe nëse është dashur të rekomandohet për në Spital në Prishtinë dhe jo në spital privat.

Dëshmitari, A. H ka deklaruar se me rastin e trajtimit të nënës së tij Sheqere Haxhijaj mjeku Elfedin Muhaxheri ka qene i përfshirë që ka udhëzuar për ta dërguar në spitalin IMH ka deklaruar se është i dëmtuar dhe parashtron kërkesë pasurore juridike, ndërsa dëshmitari Bujar tabaku ka theksuar se gjatë vitit 2013 gjersa kishte shtrëngim në gjoks ka shkuar në spitalin e Pejës ku e ka trajtuar fillimisht mjekja Afërdita Selmanaj pastaj të nesërmen është kontrolluar nga mjeku Elfedin Muhaxheri, i cili familjarëve të tij iu ka thënë që gjendjen shëndetësore dëshmitari e ka shumë në rrezik, se i funksionon vetëm gjysma e zemrës dhe duhet me shkuar në spitalin privat IMH rrugës për Ferizaj në krahun e djathtë, për me vendos stenta. Më tutje ka shtuar se pas arritjes në spitalin IMH, pa koronargrafi dhe pa fotografim, është futur në sallë dhe i janë vendosur dy stenda, për të cilat ka paguar 5.000 euro, po ashtu ka shtuar se shuma e paguar në spitalin turk IMH, ka kërkuar që t'i kompensohet nga MSH, mirëpo ka pranuar përgjigje negative sepse vendosja e stendave nuk është kryer në spitalin publik në QKUK në Prishtinë.

Dëshmitari B.B në dëshminë e dhënë në gjykatë me datë 03.02.2021 ka deklaruar se, babai i tij Zeqiri ka pasur problem me zemër, dhe për këtë arsye është dërguar në vizita mjekësore vazhdimisht në spitale apo ordianca të ndryshme, është dërguar edhe në QKUK, e me pastaj sipas udhëzimeve të emergjencës në QKUK, është dërguar në spitalin Turk, nuk i është kujtuar se kush e ka kontaktuar spitalin turk dhe kush ka kërkuar që ndihma e shpejt e këtij spitali të shkon dhe ta merr të njëjtin për ta dërguar në at spital, tutje ka shtuar se në spitalin turk i është thënë që babait të tij, duhet të i vendosen stenda, të njëjtat ja kanë vendosur sipas tyre, aty ka qëndruar dy apo tri ditë dhe çmimi i tërësishëm ka qenë 7.000 euro, të cilat i ka paguar MSH në tërësi

Dëshmitari F.G në polici me datë 14.03.2016 kishte deklaruar se, për shkak të problemeve shëndetësore me zemër, fillimisht ka bërë kontrole në QMF në Pejë e pastaj sipas rekomandimeve të bëra ka shkuar në ordinance private të dr. Daut Gorani, dhe pas ekzaminimeve të bëra, i njëjti i ka caktuar një termin në QKUK në Prishtinë për të bërë koronarografin dhe pas bërjes së koronarografis është konstatuar se ka tri vena të ngushtuara dhe duhet të bëjë bypass. Më tutje ka shtuar se me vullnetin e tij dhe pa e rekomanduar ndokush, ka shkuar në spitalin privat IMH, ka bërë tre bypass, për çka ka paguar shumë prej 6.000.00 euro, dhe gjendja

shëndetësore e saj, nga atëherë ka qenë e mirë. Vetën nuk e konsideron të dëmtuar dhe nuk paraqet kërkesë pasurore juridike.

Dëshmitari Z.M ka deklaruar se afërisht para ose gjatë vitit 2010 kur i njëjti kishte pasur problem me zemër për çka është vizituar tek mjeku Kelmend Pallaska në QKUK dhe është referuar në spital privat në Gjakovë.

Dëshmitari L.B ka deklaruar se nëna e tij A... ka qenë e sëmurë nga diabeti dhe me datë 30.09.2013 ka pas një sulm kardiak në zemër, e ka dërgu në Spitalin Rajonal në Mitrovicë ku mjek kujdestar ka qenë mjeku Mirdi Strana i cili e ka kontrolluar dhe ka konstatuar se duhet t'i vendoset stenda, mirëpo që nuk ka stenda në Spitalin Rajonal të Mitrovicës, dhe ju mbetet atyre si familjar me bë zgjidhje për ndonjë spital privat, për çka janë përcaktuar për spitalin IMH sepse çmimi ka qenë më i arsyeshëm në krahasim me spitalet tjera private Më tutje ka shtuar se me datë 15.10.2013, ka pas prap një sulm në zemër, fillimisht është dërguar në Spitalin Rajonal të Mitrovicës, pastaj në IMH, ku është intereenuar me qëllim të zhbllokimit të kanalit, nga data 17 deri 21.10.2013 ajo ka qëndruar në komë dhe me datë 21.10.2013 rreth orës 13:00 ka ndërrua jetë në spital, mirëpo që spitali IMH për lirim të kufomës ka kërkuar edhe 1.500 euro për ato tri ditë që ka qëndruar në spital dhe vëllai i tij është detyruar që letërnjoftimin t'a dorëzoj si peng derisa të bëhet pagesa e shumës prej 1.500 eurove. Më tutje dëshmitari, pasi që ka deklaruar nuk i kujtohet të ketë pranuar ndonjë Fletë Lëshim nga Spitali në Mitrovicë, është ballafaquar me fletlëshimin e datës 30.09.2013, ku është konstatuar se pacientja në marrëveshje me familjarët dërgohet në QKUK për egzaminimin invaziv kardiologjik koronografi, për Çka ka deklaruar se nuk i kujtohet që mjeku Mirdi Strana ka përmendur QKUK. Ka deklaruar se e konsideron veten palë të dëmtuar dhe paraqet kërkesë pasurore juridike, pasi që përveç 4.000 euro që ka paguar kesh, ka bërë edhe shpenzime për udhëtime në Prishtinë dhe anasjelltas.

Dëshmitari A.D në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se si pasojë e shtrëngimeve në gjoks fillimisht ka shkuar në Shtëpinë e Shëndetit në Lipjan, e pastaj ka shkuar në QKUK, është kontrolluar nga mjeku kujdestar, emri i të cilit nuk i është kujtuar, pas kontrolleve të kryera i është thënë që dy damar të zemrës nuk i punojnë, në QKUK nuk ka mundësi mu intervenu dhe me iu vendos stendat dhe në këtë moment, familjarët e tij janë interesuar për të gjetur një spital privat, ashtu që është vendosur të dërgohet në spitalin turk, ambulanca e të cilit spital e ka marr, është vendosur në sallën e intervenimeve, ku fillimisht i është vendosur një stende, dhe pastaj pas dy dite i është vendosur edhe një stende tjetër, e që për këtë ka paguar shumën prej 5.700 euro, po ashtu ka shtuar se përkundër që ka bërë kërkesë për kompensim në MSH, e njëjta nuk i

është aprovuar me arsyetimin se kërkesën nuk e ka paraqit me kohë dhe e konsideron veten të dëmtuar e paraqet kërkesë pasurore juridike.

Dëshmitarët F. U dhe D.T qe te dy kanë sqaruar se ata janë trajtuar për problemet shëndetësore, dhe qe te dy kanë deklaruar se nuk e konsiderojnë veten te dëmtuar dhe nuk kane paraqitur kërkesë pasurore juridike.

Dëshmitarja B.R në shqyrtim gjyqësor, si pasojë e problemeve me shtypje të gjakut, është paraqitur te dr.Hamza mbiemri i të cilit nuk i është kujtuar, në ambulance e tij në Ferizaj, dhe pas kontrollës, i është thënë se është keq me zemër dhe se duhet të shkoj te spitali EDA, mirëpo që lidhur me këtë rrethana, dëshmitarja ka bërë pohime të ndryshme, pasi që më vonë gjatë dëshmisë ka deklaruar se mjeku Hamza i ka thënë vetëm se duhet të shkoj në një spital privat cili do qoftë, e pastaj në spitalin turk i ka thënë të shkojë asistenti i këtij doktori, mirëpo ajo ka vendosur që të shkojë në spitalin EDA, ak theksuar se pastaj ne kontroll ne këtë institucion i është thënë se duhet bere incizim dhe i është thënë se te është vendosur një stendë mirëpo kur ka shkuar ne Gjermani i është thënë nga mjeket se Stenda nuk i është vendosur se nuk ka arsye me vendos, ka deklaruar se për këtë shërbim ne EDA ka paguar shumen prej 4.000 euro, ka deklaruar se ndihem e dëmtuar dhe ka paraqitur kërkesën pasurore juridike.

Dëshmitari U.K ka deklaruar se, rreth viti 2012 apo 2013 nëna e tij ka pas probleme shëndetësore, e ka dërguar në Qendrën Familjare në Gjakovë, ku është konstatua se për shkak të mërziisë, stresit, ka pas shqetësim, mirëpo që pas 3 apo 4 dite, është dashur përsëri të paraqitet, për çka edhe e kanë dërguar në intensivë në spitalin regjional të Gjakovës, ku kontrolli është bërë nga mjekët Luan Pazhari dhe Amir Ilazi, ku i është thënë se nëna ka pas infarkt në zemër, dhe duhet me shku mi vendos stendat në Prishtinë, ambulanca ka qenë e përgatitur për me dërgua nënën në Prishtinë, vetëm kanë mugu paratë, mirëpo pas analizave që i janë bërë prape një nga kolegët e doktorëve në spital, i njëjti i ka thënë se nuk është ashtu si thojnë doktorët, merre nënën dërigo në shtëpi, por pa e vërejt stafi mjekësore, sepse i ka kolegë, pastaj i ka pohuar dr.Luan Pazharit, faktin se dëshiron me largu nënën nga spitali, mirëpo i njëjtit mirëpo i njëjti ka insistuar që nëse e tërheq, ka me vdekë, dhe pasi dëshiron me heq, se pari, duhet me ja ba një incizim, i cili i është bërë në një spital privat, në të cilin i ka dërguar tani i akuzuari Luan Pozhari, e ku ka paguar 150 apo 250 euro për atë shërbim, thekson se e konsideron veten te dëmtuar dhe paraqet kërkesë pasurore juridike.

Dëshmitari N. K ka deklaruar se, ka punuar si kontabilist në spitalin “Intermed shpk”-EDA nga viti 2007-2012 por me shkëputje dhe aty ka zbatuar listën e pagave ndaj të gjithë atyre që në

ndonjë formë kanë punuar si të rregullt kanë ofruar shërbime për këtë spital, qofshin mjekë apo personel tjetër dmth ë që kanë asistuar në sallën e e intervenimeve, që kanë kujdestarë që kanë punuar në ambulancën e këtij spitali etj dhe, çdo pagesë ka shkuar përmes llogarisë bankare, përndryshe asnjëherë nuk ka asistuar e as nuk ka pa se dikujt i është bërë ndonjë pagesë me kesh. Listën e pagave ia ka dhënë Borche Petrovski dhe një person përgjegjës që ia ka dorëzuar emrat e atyre që kanë punuar në spital në ofrimin e shërbimeve të ndryshme, në ato lista janë të shënuara emri, mbiemri dhe bruto kompensimi me ndalesë për tatim në burim dhe kontributi pensional për secilin.

Dëshmitarja H.I-F ka deklaruar se, nga viti 1999 ka punuar vetëm në QKUK si kryeinfermiere në ambulancë specialiste për vizita kardiologjike. Në zyrën e saj siç thekson dëshmitarja kanë pranuar dokumentacionin e palëve që kërkojnë shërim jashtë institucionit shëndetësor publik, pacienti nuk është e nevojshme të jetë i pranishëm, pra flet lëshimi i kardiologjisë me diagnozë dhe dokumentacioni tjetër që ata e kanë siguruar, atëherë ai komision (koziliar) i caktuar nga Drejtori i Klinikës Bedri Zahiti është mbajtur aty, kanë vendosë në bazë të UA, dëshmitarja e ka poseduar edhe atë shkresë të drejtorit, për secilin rast anëtarët kanë qenë të ndryshëm, dhe për sëmundjet që nuk trajtohen në QKUK komisioni ka vlerësuar pastaj kanë shkuar në MSH. Për rastet me infarkte akute apo emergjente janë lëshuar menjëherë letrat referuese, pacientin nuk kanë mund ta shohin, pastaj nuk kanë pas informacione se çfarë ka ndodhë me pacientin se a ka vdekur apo jo.

Dëshmitarja Sh. A ka deklaruar se ka pasur probleme shëndetësore ku në vitin 2013 ka humbur vetëdijen dhe ka shkuar në shtëpinë e shëndetit ku është kontrolluar nga Mjeku Besnik Koliqi i cili ka udhëzuar që të dërgohet në Qendrën Spitalore në Mitrovicë i njëjti ka konstatuar se pacientja ka pësuar sulm dhe është në rrezik për jetën dhe ju ka propozuar familjareve të saj që të shkojnë në spitalin IHM për trajtim, e njëjta ka shkuar në këtë spital dhe nuk e din se kush e ka thirrur automjetin e këtij spitali e njëjta ka deklaruar se ka shkuar dhe i është vendosur një stendë që ka paguar shumën prej 4000 euro, ka theksuar se ka parashtruar kërkesë për kompensim por që të njëjtës i është refuzuar kërkesa nga Ministria pasi që nuk ka qenë e shtruar në QKUK, dhe se vërtetimi i një dokumenti që konstaton se vetëm ka qenë në QKUK nuk është i mjaftueshëm.

Dëshmitarja S. A ka deklaruar se bashkëshorti i saj ka pasur probleme shëndetësore ku ka shkuar në mjekim te mjeku Driton Miftari i njëjti i ka rekomanduar që të shkojë në Spital në Mitrovicë ku e kanë trajtuar në mënyrë profesionale dhe meqenëse gjendja ishte e rëndë mjeku Driton i ka rekomanduar që ta dërgojnë në spitalin Turk për trajtim duke iu thënë se në QKUK nuk mund të

ju garantoj, ajo thekson se e kemi dërguar ne spitalin Turk si pa shpirt, aty është konstatuar se u janë mbyllur damarët e zemrës dhe duhet mi vendos stenda i janë vendosur dy stenda ku kanë paguar shumen prej 4000 euro dhe pas dy dite serish është dërguar ne spital dhe i njëjti ka ndërruar jete, e njëjta ka deklaruar se nuk ka paraqitur kërkesë për kompensim dhe nuk e konsideron veten te dëmtuar.

Dëshmitari Nj. Gj si drejtor ekzekutiv në QKUK ka sqaruar se të gjitha klinikat në QKUK kanë pasur komision konzoliar që kanë dhënë rekomandimet për trajtim jashtë institucioneve publike dhe se ato rekomandime kanë shkuar ne Ministrinë e shëndetësisë për tu vlerësuar për rimbursim sipas legjislacionit ne fuqi.

Dëshmitari C. Gj si drejtor i SHSKUK-se në shqyrtim gjyqësor ka sqaruar se si kanë rrjedhur procedurat e rimbursimit, ku ka sqaruar se kanë ekzistuar dy procedura e rregullta dhe ajo urgjente, të procedura e rregullt ka sqaruar se kanë ekzistuar tri shkalle, që ka qenë komisioni konzoliar që kanë dhënë letrën rekomanduese në të cilën kanë qenë mjekë profesionist nga klinika e QKUK-se, si nivel terciar i specializuar, dhe nga aty ka qenë faza e dytë që ka qenë në nivel të ministrisë që është dashur të kujdesen nëse ka pasur lëshime apo kanë kaluar afatet për rimbursim pasi që këtu është dorëzuar kërkesa dhe është kompletuar lënda në tërsi e është përpiluar lista, dhe si organ përfundimtar ka qenë Bordi i Ministrisë së Shëndetësisë qe vetëm ky organ ka pasur kompetencë për aprovim apo refuzim të kërkesës.

Dëshmitari L.B ne deklaratën e dhënë ka theksuar se ai ka qenë kardiolog i punësuar ne spitalin EDA dhe poashtu ka qenë në cilësinë e drejtorit pranë këtij spitali, lidhur me të pandehurin ka deklaruar se nuk ka qenë në dijeni se i pandehuri Daut Gorani të këtë qenë i punësuar ne Spitalin EDA, ndërsa pjesa tjetër e deklaratës i referohet situatave tjera në raport me tërsin e aktivitetit te këtij institucioni shëndetësor, por nuk i referohet rrethanave të të pandehurit Daut Gorani.

Dëshmitarja F. K ka deklaruar se e njëjta ka qene e punësuar pran spitalit privat IMH ne cilësinë e kontabilistit Junior, ajo ka sqaruar se ka bere pagesa për stafin dhe se pagesat disa janë bere ne banke dhe disa ne kesh, dhe pagesat janë bere varësisht nga lista e drejtorit A. T ajo i ka kryer pagesat, ajo ka deklaruar se pagesat janë bërë edhe ndaj të pandehurit ne kesh, dhe se të gjitha pagesat çdo hyrje dhe dalje që është bërë është raportuar në mëngjes, pranë drejtorit A..., Dëshmitarja ka sqaruar se ka qenë lista ne gjuhen turke dhe i kujtohet se ka qene, “Doctor refere ve Konsult”, në të cilën liste ka qenë emri i doktorit emri i pacientit, vlera dhe se pagesat u janë

bere në baza javore doktorëve, ndërsa ajo ka sqaruar se nuk ka pasur të drejtë të hyje nëpër salla për të verifikuar se çfarë punësh kanë kryer dhe nuk kanë pasur të drejtë të pyesin mjekun se çfarë shërbimi kanë dhënë doktorët për pacientët. Dëshmitarja ka sqaruar se çdo pagese është bere përmes paragonit në kesh ku kane qene fletëpagesat ne tri kopje, poashtu ka sqaruar se pagesa e pagave kane qene me bankë ndërsa pagesa e refere dhe konsultë kane qene me kesh duke sqaruar se nuk i kujtohet se përse ka qene ky dallim.

Nga të gjithë këta dëshmitar te dëgjuar, nuk rezulton se provohen faktet si për sa i përket, tejkalimit te kompetencave apo qëllimit të të pandehurve për te vepruar ne shkaktim të dëmit buxhetit te Kosovës.

Kolegji ka parasysh se dëshmitarët e dëgjuar në shqyrtim gjyqësor siç janë, A. O, A. U, N. D, B. H, I.S, M. H, S.R, F. K, D. B, Q.Y, F. G, F. U, D. T, te gjithë këta dëshmitar kanë deklaruar se ata nuk janë te dëmtuar dhe nuk kanë parashtruar kërkesë pasurore juridike rrjedhimisht përmes këtyre deklaratave te dëshmitarëve nuk mund të vërtetohet se të pandehurit kanë pasur qëllim të shkaktimit të dëmit qofte ndaj pacientëve në raport me këta dëshmitarë apo qoftë ndaj buxhetit të vendit duke qene se ishte përcaktuar programi i tillë me legjislacionin në fuqi për dhënien e subvencionimit për pacientet që ishin trajtuar jashtë institucioneve publike dhe se letrat referuese nuk ishin vendimet e tilla të natyrës administrative që përcaktonin subvencionimin por ishin një nga kushtet qe duheshin për rimbursimin e pacienteve që ishin trajtuar jashtë institucioneve publike, ndërsa rimbursimi që bëhëj rezultonte vetëm me vendimin që e merrte komisioni në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë.

Ndërsa dëshmitarët, si A.B ka deklaruar se nuk i është drejtuar organeve për kompensim, N.H deklaron se i janë paguar shuma prej 70% nga Ministria, B. A deklaron se është refuzuar nga Ministria për kompensim, H. K deklaron se nuk i ishte dhënë udhëzim për QKUK, Sh.B deklaron se nuk i ishte dhënë udhëzim për QKUK, Z. B thekson se nuk ka bere kërkesa ne Ministri për kompensim, B. T deklaron se i është refuzuar kërkesa për kompensim nga MSH, B.B deklaron se i janë rimbursuar mjetet nga Ministria, L.B deklaron se nuk është ne dijeni se i është përmendur QKUK mirepo rezulton fletleshimi nga i pandehuri Mirdi Strana per QKUK, A.D ka pohuar se i është refuzuar kërkesa për kompensim, nga të gjithë këta dëshmitar nuk rezulton ekzistimi i dëmtimit të shkaktuar si pasoj e të pandehurve që kanë dhënë referimet për trajtim ne institucionet Private, pasi që si atyre që u janë refuzuar ashtu edhe atyre që u janë aprovuar kërkesat për rimbursim të shpenzimeve në institucione jo publike shëndetësore, janë marr

vendimet nga ana e Komisionit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe ky nuk ishte një veprim i të pandehurve që kane dhënë referenca për trajtim jashtë institucioneve publike shëndetësore.

Ndërsa dëshmitarët tjerë poashtu që kanë deklaruar se e ndjejnë veten të dëmtuar, nuk kane dhënë sqarime se në çfarë drejtimi pretendohet dëmtimi i tyre a ishte për shkak se nuk u janë aprovuar kërkesat apo ishte për shkak se ata vlerësojnë se nuk janë trajtuar mirë nga mjekët me rastin e trajtimit apo ishte për shkak se konsiderojnë se ndërhyrjet me stentim ishin bere pa nevojë nga mjekët nëpër spitale private, kjo për faktin se në rast se kemi të bëjmë me pretendime të tilla që ata e konsiderojnë veten të dëmtuar atëherë mund të behet fjale për elemente të ndonjë veprë tjetër penale dhe jo për veprë penale të tejkalimit të detyrave zyrtare siç prokuroria i ngarkonte të akuzuarit në bashkryerje për veprën penale nga pika 1 e dispozitivit.

Andaj kolegji i gjykatës së Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt i ka vlerësuar deklaratimet e dëshmitarëve që ka dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor, dhe se drejtë e në mënyrë të plote ka vërtetuar faktet se me deklaratimet e këtyre dëshmitarëve nuk vërtetohet se të pandehurit kanë kryer veprën penale si në pikën I të dispozitivit për keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar dhe poashtu se nga deklaratimet e këtyre dëshmitarëve nuk mund të vërtetohet asnjë rrethanë për sa i përket pikës II të dispozitivit e ngarkoheshin të pandehurit me veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 e lidhur me veprën penale të ,marrjes së ryshfetit, pasi që nuk provohet as tejkalimi i detyrave zyrtare, dhe as qëllimi i të pandehurve për shkakimin e dëmit apo përfitimin, dhe nuk provohet as marrja e ryshfetit nga ana e të pandehurve.

Kolegji ka parasysh provat materiale që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor, dhe konkretisht nga marrëveshjet e arritura ndemjet ministrisë së shëndetësisë dhe institucioneve private, kolegji këto prova materiale i vlerëson se nuk kanë karakter të provave për të vërtetuar inkriminimin e të pandehurve duke qenë se ato janë të lidhura ndërmjet dy subjekteve tjera dhe të pandehurit nuk kishin asnjë veprim në lidhjen e tyre, ndërsa këto prova vërtetojnë faktin se pacientëve që kërkonin trajtim në QKUK kur plotësonin kushtet ligjore ata mund të trajtoheshin në spitalet private.

Kolegji poashtu ka parasysh se të pandehurit ishin pjesë e komisioneve konzoliare që kishin lëshuar letrat referuese për trajtim, gjë që veprime e tyre ishin të rregulluara sipas dy udhëzimeve administrative, UA 02/2012 dhe UA 03/2013, megjithatë çështja e pagesës së shërbimeve nuk

përfundohej me sigurimin e letrave referuese për trajtim jashtë institucioneve publike, rrjedhimisht procedura ishte tutje për rimburoje duke aplikuar dhe duke dërguar dosjen pranë bordit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe vetëm në këtë situatë kur vendosej nga bordi mund të rimburohej shpenzimi i mjekimit jashtë institucioneve publike, gjë që në veprimet e të pandehurve edhe kur janë lëshuar si anëtar i komisionit letrat referuese nuk rezultojnë se ishte krijuar pasoja e dëmtimit të buxhetit pasi që në ligjet për buxhet rezultojnë të ndara në kuadër të kodit buxhetor mjetet monetare që ishin përcaktuar për pagesën e trajtimit shëndetësor jashtë institucioneve publike.

Lidhur me raportet e inspektoratit shëndetësor që ka konstatuar se nuk kishin licencim, kolegji ka parasysh se provat e tilla nuk vërtetojnë asnjë nga faktet që do të ndërlidhnin të pandehurit me veprën penale, kjo pasi që rrjedhe se të pandehurit kishin cilësinë e Mjekeve në sektorin e spitaleve publike, dhe se ata nuk ishte as pronar i ndonjë institucioni shëndetësor dhe njëkohësisht nuk rezultojnë se të njëjtët në cilësinë e mjekëve të mos kenë pasur licencë për ushtrimin e profesionit, ndërsa për faktin se të pandehurit kanë lëshuar letrat referuese si anëtar i grupit mjekësor konzoliar në këto letra referuese askund nuk konstatohet se në cilin institucion privat shëndetësor duhet të trajtohet pacienti duke qenë se ajo i ka takuar pacientit që të bëjë zgjidhjen, andaj raportet e inspektoratit nuk e ndërlidhin asnjë rrethanë faktike të pretenduar në akuze nga ana e prokurorisë lidhur me veprimet që i viheshin në barre të pandehurve.

Kolegji i gjykatës së Apelit vlerëson se drejte janë vlerësuar provat për sa i përket gjendjes faktike gjegjësisht fletoreve që janë gjetur dhe sekuestruar nga policia në dy spitale private, duke qenë se fletoret e tilla fillimisht nuk janë identifikuar saktësisht se kujt i përkisnin, në anën tjetër nuk rezultojnë se ishte bërë ndonjë ekspertizë grafologjike me anë të se cilës do të mundësohej identifikimi se kujt i takonin pastaj për të mundësuar edhe provueshmërinë e fakteve përmes provës së tilla, në rrethana të tilla kolegji vlerëson se është i drejtë vlerësimi i këtyre provave nga ana e gjykatës së shkallës së parë, kur ka konstatuar se nuk mund të nxjerrët provueshmëria e fakteve pa mëdyshje për tu provuar se të dhënat e tilla a janë të sakta, nga se ka të shënuara emra dhe shuma të ndryshme mirëpo nuk mund të provohet se shumatat e tilla a u janë dhënë personave që janë të shënuar në ato fletore, kur u janë dhënë ato shumatat për çfarë veprimi pretendohet se u janë dhënë konkretisht, kush ua ka dhënë shumatat e tilla, të gjitha këto fakte vendimtare mbështetura nga provat e tilla gjegjësisht fletoret që janë administruara si prova rrjedhimisht kolegji vlerëson se provat janë vlerësuar drejtë dhe se gjendja faktike përmes këtyre provave nuk mund të vërtetohet përtej dyshimit.

Sa i përket ekspertizave të ekzaminimit elektronik të kompjuterëve, kolegji vlerëson se raportet e këtyre ekspertizave janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, ashtu siç ka konstatuar edhe gjykata se nga ekzaminimi kanë rezultuar të dhëna nga tabela në exel ku ka shënime si emra të mjekeve dhe shifra të shumave monetare, megjithatë kolegji pranon si të drejtë vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë, duke qenë se të dhënat e tilla nuk konfirmojnë faktet si në vijim, kur ishin bërë këto pagesa a kishte konstatim të pranimit të pagesave nga ana e mjekeve në rastin konkret nga të pandehurit, për çfarë ishin bërë këto pagesa, a ishin bërë për shkak të punës që ishin të angazhuar në institucione private shëndetësore apo ishin bërë për qëllime korruptive, për cilat raste apo pacient ishin bërë këto pagesa nëse pretendohet se ato ishin bërë për qëllime korruptive, duke qenë se përmes këtyre provave – raporteve të ekzaminimit e në ndërlidhje dhe me provat tjera derisa nuk mund të vërtetohen këto fakte me rëndësi thelbësore për të konkluduar se të pandehurit ishin përfshirë në veprime të keqpërdorimit dhe në veprime të marrjes së ryshfetit, kolegji vlerëson se drejte dhe në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike nga gjykata e shkallës së parë kur ka konstatuar se nuk provohet se kanë kryer veprat penale të pandehurit, pasi që nga provat e tilla nuk mund të vërtetohet gjendja faktike përtej dyshimit të bazuar mirë.

Sa i përket raporteve policore dhe raporteve të bastisjes, fillimisht kolegji vëren se në raport me të pandehurit që ngarkohen si në piken I dhe II të dispozitivit, me rastin e bastisjes nga procesverbalet rezulton se nuk ishte gjetur ndonjë provë me vlere apo diç e kundërligjshme, poashtu lidhur, me listat e kujdestarisë për vitin 2011 o 2012, kjo rrethanë nuk është kontestuar pasi që të pandehurit kanë qenë kujdestar dhe nuk kanë mohuar, nga ana tjetër ata nuk kanë mohuar se kanë lëshuar letrat referuese për trajtim jashtë institucioneve publike shëndetësore, por se siç u sqarua me sipër letrat e tilla nuk krijojnë pasojën e veprës penale si të vetme dhe rrjedhimisht tutje nuk është argumentuar se të njëjti kanë vepruar në kundërshtim me detyrat e tyre dhe poashtu nuk rezulton të provohet se përmes letrave që janë lëshuar në kohën kur të pandehurit ka qenë kujdestar, që si pasojë e lëshimit të atyre letrave të kenë pranuar ryshfet, andaj si të tilla listat e kujdestarisë nuk provojnë faktet inkriminuese të pretenduara në raport me të pandehurit.

Kolegji ka parasysh edhe provat materiale gjegjësisht masat teknike të hetimit dhe vëzhgimit të zbatuara nga ana e Prokurorisë, nga të cilat rezultojnë se të pandehurit kanë pasur komunikime me personat tjerë dhe ndërmjet tyre dhe se komunikimet e tilla ndërlidhen me rrethanat e fakteve,

megjithatë kolegji poashtu ka parasysh se dispozitat ligjore ne rastin konkret duhet te kihen parasysh se nuk duhet cenuar me veprime procedurale për sigurimin e provave.

Fillimisht kolegji ka parasysh se, dispozitat ligjore në kohën kur janë zbatuar masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit, janë rregulluar sipas kodit te procedurës penale, 04/L-123, i cili kod ne 84 ka rregulluar zbatimin e masave të fshehta para fillimit të procedurës penale, gjegjësisht ne paragrafin 1 dhe 2 ka përcaktuar se: “1. Nëse prokurori i shtetit ka dyshim të bazuar se është kryer vepër penale nga neni 90 të këtij Kodi, po kryhet apo së shpejti do të kryhet, prokurori i shtetit mund të autorizojë apo të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake që të autorizojë masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit në pajtim me nenet 86-100 të këtij Kodi. “ 2. Për autorizimin e masave të fshehta dhe teknike të hetimit dhe vëzhgimit nga paragrafi 1, prokurori i shtetit ose gjyqtari i procedurës paraprake nuk është e domosdoshme të ketë dyshim të arsyeshëm për identitetin e të dyshuarit apo të dyshuarve të cilët kanë kryer, janë duke kryer ose së shpejti do të kryejnë vepër penale”. Ndërsa paragrafi 4 ka parapare se: Procedura penale nuk kërkohet që të jetë filluar për autorizimin nga prokurori i shtetit apo gjyqtari i procedurës paraprake të masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit nga paragrafi 1; sidoqoftë, procedura penale fillohet **posa prokurori i shtetit të ketë dyshim të arsyeshëm për identitetin e të dyshuarit apo dyshuarve që kanë kryer vepër penale.**

Kolegji vëren se, prokuroria ka filluar procedurën penale me date 16.06.2014 ndaj pandehurve qe i ngarkonte për veprat penale ne bashkëkryerje, ndërsa ka marr aktvendimin për zgjerimin e hetimeve ku ka zgjeruar hetimet, me aktvendimin e datës 11.01.2016. Ndërsa si veprime të zbatimit të masave rezultojnë se sipas kërkesës se prokurorisë ishte lëshuar urdhëresa e Gjykatës për nxjerrjen e bisedave (sms -ve për muajin, maj, korrik, gusht dhe shtator 2012), çka rezulton se urdhëresa ishte zbatuar për veprime retroaktive te marrjes se SMS-ve. Kolegji poashtu ka parasysh se, SMS sipas nenit 90 te kodit qe ishte ne fuqi janë kategori e masave te, përgjimit te telekomunikimeve, qe ne paragrafin 5 te këtij neni është parapare, se: “ Shprehja “përgjim i telekomunikimeve” do të thotë përgjim i komunikimeve zanore, **komunikimeve tekstuale** ose komunikimeve tjera përmes rrjeteve të telefonive fikse apo mobile. Kjo përfshinë çfarëdo mjeti apo sistemi tjetër të ngjashëm teknologjik që bartë të dhëna që kryesisht kanë për qëllim të jenë private, rrjedhimisht edhe sms i nënshtrohen kushteve te parapara ne nenin 84, ku si kriter rezulton se në parim nuk është e nevojshme dijenia e identiteti te kryerësve kur lëshohet masa e përgjimit por se në momentin kur mësohet identitetit atëherë prokuroria duhet filluar hetimet.

Kolegji përveç se këto prova të marra përmes masave të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit i ka vlerësuar në drejtim të kushteve ligjore nga neni 84 dhe 90 i kodit të procedurës penale që ka qenë në fuqi në kohën kur janë siguruar (qe poashtu kërkesa te njëjta te kushteve ligjore janë

parapare edhe me kodin e procedurës penale qe është aktualisht ne fuqi), ka parasysh se, tanimë edhe sipas aktgjykimit te gjykatës Kushtetuese, ne rastin KI.113/21 i datës 15.01.2022, ne paragrafin 95 te këtij aktgjykimi Gjykata Kushtetuese ka konsoliduar standard kushtetues lidhur me zbatimin e masave në mënyrë retroaktive përfshirë SMS-te, gjë që ka konstatuar se veprimi retroaktiv i sigurimit te komunikimeve nuk është mase e parapare me ligj dhe bie ndesh me parimet e te drejtës për privatësi, rrjedhimisht kolegji i vlerëson si të drejta konkludimet e gjykatës së shkallës se parë, se përderisa kemi të bëjmë me marrjen e sms ne mënyrë retroaktive qe përfshinë periudhën 2012 ndërsa hetimet kishin filluar në periudhën 2014 gjegjësisht 2016, është e qartë se veprimet e tilla bien ndesh me standardin e përcaktuar sipas aktgjykimit te Gjykatës kushtetuese me rastin e vlerësimit te drejtës për private, rrjedhimisht rezulton se veprimet e tilla janë ne kundërshtim edhe me nenin 84 dhe 90 te Kodit të procedurës penale që ishte në fuqi në kohen kur janë zbatuar këto veprime procedurale të marrjes se SMS-ve, gjë qe kolegji vlerëson se me të drejte gjykata e shkalles së parë masat e fshehta teknike te hetimit dhe vëzhgimit të zbatuara në rastin konkret – marrjen e SMS nga operatorët e telekomunikimeve, cenon të drejtën për privatësi, dhe se si të tilla këto veprime dhe masa duhet te trajtohen si prova te papranueshme, gjë qe përmes këtyre provave nuk mund te mbështetet çështja e fajësisë përderisa rezultojnë se janë siguruara ne kundërshtim me nenin 84 dhe 90 si qe do te cenonin standardin kushtetues te konfirmuar nga Gjykata Kushtetuese me aktgjykimin e lartë theksuar.

Lidhur me ekspertizën financiare kolegji ka parasysh se, kjo ekspertize financiare ishte bërë për një çështje te tërësishme, nga e cila ekspertizë eksperti kishte konstatuar se demit i shkaktuar ishte ne vlerën prej 11.430 euro, shume kjo qe i vihej ne barrë te pandehurve qe ngarkoheshin ne bashkëkryerje.

Kolegji rikujton se vlere e demit ne buxhetin e Kosovës duhet te kihet parasysh se nuk mund te shkaktohet nga ana e të pandehurve që kanë lëshuar letrat referuese për trajtim jashtë institucioneve duke qenë se përmes këtyre letrave ishte vetëm mundësia që në procedurën administrative pacientët të kërkonin mbulimin e shpenzimeve, por se kërkesat e tilla për tu aprovuar apo refuzuar nuk ishin në kompetencën e të pandehurve gjegjësisht për këto kërkesa vendoste Bordi në kuadër të Ministrisë së shëndetësisë, andaj ekspertiza e tille nuk vërteton shkaktimin e demit me anë të veprimeve të të pandehurve por nëse ka pasur dem rezulton se demit është shkaktuar nga ana e organit qe kanë marr vendimet për rimbursim apo mbulim te shpenzimeve ne raport me kërkesat e paraqitura nga ana e pacienteve, rrjedhimisht kjo provë nuk provon ndonjë fakt ne raport me te pandehurit për tu konsideruar se veprimi i tille përbente konsumim të elementeve të veprës penale, ndërsa kjo prove ne raport me piken 2 për veprën

penale që ngarkoheshin të pandehurit për marrje të ryshfetit, nuk provon marrjen e ryshfetit nga ana e të pandehurve përmes spitaleve që janë trajtuar pacientet, rrjedhimisht prova e tillë e vlerësuar në këtë drejtim duke mos vërtetuar gjendjen faktike në raport me veprimet e të pandehurve, edhe për Gjykatën e Apelit rezulton se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga gjykata e shkallës së parë.

Kolegji ka parasysh se me provat që janë administruar për piken I të dispozitivit, nuk arrihet të vërtetohen faktet që ndërlidhen me elementet e veprës penale, me konkretisht duke qene se pretendohet se janë lëshuar të paktën 233 letra referuese nga gjithë të pandehurit për trajtim jashtë vendit gjegjësisht jashtë institucioneve publike dhe se me këto veprime është shkaktuar dëmi në shumën prej 11.430 euro, nuk mund të vërtetohet se cilat kompetenca i kishin tejkuluar të pandehurit kur kishin lëshuar letrat referuese, se a ishin ato letra referuese ku kishin marr pjesë të pandehurit të ndërlidhura drejtpërdrejt me dëmin e shkaktuar për tu konsideruar se kishte lidhje shkakësore, nuk provohet se pasoja e shkaktimit të dëmit është si shkak i letrave referuese duke qene se pagesat janë bërë si pasojë e vendimeve që janë marr nga bordi dhe jo si pasojë e lëshimit të letrave referuese nga konsiliumi i mjekëve.

Poashtu në raport me piken 2, me provat që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor, kolegji vlerëson se nuk provohen faktet vendimtare për veprën penale të marrjes së ryshfetit, konkretisht cilët ishin pacientët që ishin referuar specifikisht nga secili prej të pandehurve, kur ishin referuar këta pacient nga në spitalet private për trajtim, cila ishte shuma konkrete që ata kishin paguar cilët nga ta ishin rimbursuar për shpenzime nga buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë, kur ishin paguar këto mjete monetare dhe nga kush ishin paguar këto mjete monetare dhe ku ishin paguar këto mjetet monetare që pretendohet se ishin mjete monetare të marrjes së ryshfetit.

Andaj kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike kur ka ardhur në konkludimin se nuk është vërtetuar se të pandehurit kanë kryer veprat penale për të cilat akuzoheshin, pasi që rezultoi se me provat e administruara nuk vërtetohen faktet përtej dyshimit të bazuar për të ardhur në një përfundim të arsyeshëm e racional se të pandehurit kanë kryer veprat penale, prandaj për të gjitha këto arsye kolegji e ka vlerësuar si të pabazuar ankesën e prokurorisë për sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Gjykata e Apelit duke shqyrtuar pretendimet ankimore të prokurorisë për sa i përket bazës ligjore për shkelje të ligjit penal, ka parasysh se prokuroria nuk thekson ndonjë dispozite që i referohet shkeljes së ligjit penal, mirëpo pretendimet e shkeljes së ligjit penal ndërlidhen me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe me vërtetim të gabuar e jo të plotë të gjendjes faktike.

Kolegji duke i shqyrtuar këto pretendime gjen se ankesa e prokurorisë edhe në drejtim të shkeljes së ligjit penal është e pabazuar, kolegji vlerëson se aktgjykimi nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe poashtu gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, andaj rrjedhimisht për shkak të këtyre bazave që pretendon prokuroria në ankese nuk rezulton as shkelja e ligjit penal, dhe se kolegji i kësaj gjykate vlerëson se drejte është zbatuar ligji penal nga ana e gjykatës së shkallës së parë duke qenë se nga provat që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor të cilat janë vlerësuar në përputhje me dispozitat ligjore, dhe janë dhënë arsye për secilën prove e në tërësinë e tyre nuk vërtetohet përtej dyshimit se të pandehurit kanë kryer veprat penale që ngarkoheshin.

Kolegji ka parasysh edhe analizimin dhe arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë lidhur me vlerësimin e elementet të veprës penale në raport me gjendjen faktike që pretendohet në akuzën e prokurorisë, dhe që është arsyetuar nga gjykata e shkallës së parë në faqe 113 – 119 të aktgjyimit të ankimit, dhe se kjo gjykate vlerëson se arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë për sa i përket gjendjes faktike lidhur me elementet e figurës së veprës penale që akuzoheshin të pandehurit si në pikën I dhe II të dispozitivit, por edhe lidhur me formën e bashkëpunimit – bashkryerjen që ngarkoheshin të pandehurit, kjo gjykatë i akcepton në tërësi arsyet e dhëna duke qenë se janë dhënë arsye se cilat elemente të veprës penale nuk kanë arritur që të provohen e poashtu edhe lidhur me paprovueshmërinë e formës së bashkëpunimit – bashkryerjen gjë që ka dhënë arsye të qëndrueshme se përse nuk është provuar se të pandehurit kanë kryer veprat penale që ngarkoheshin sipas akuzës së prokurorisë.

Sa i përket të pandehurve kundër të cilëve është pushuar procedura dhe të pandehurve ndaj të cilëve është veçuar procedura, e të cilët përmenden në aktgjykimin e ankimit, kjo gjykatë në raport me ta nuk ka shqyrtuar ankesën pasi që ndaj të pandehurit Daut Gorani ka vendim të veçantë meritator ndërsa ndaj të pandehurve që është pushuar procedura konstatohet në aktgjykimin e ankimit se të njëjtit kanë ndërruar jetë.

Andaj për arsyet e theksuara si më lartë kjo Gjykatë bazuar në nenin 401 të KPP-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Departamenti Special

APS.Nr.20/2024 me datë 08.07.2024

B. Profesional

Gazmend Ramadani

Anëtarët e kolegjit

Burim Ademi

Kryetar i kolegjit,

Vaton Durguti

Afërdita Bytyçi
